



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 643/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06/09/2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me objekt “*Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë*” me nr. Ref 20552-07-13-2017 me fond limit 199,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05.08.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.

Ankimues:

“Higjena” sh.p.k.
Adresa: Rr “Stiliano Thona”
Kuçovë

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kuçovë
Adresa: Sheshi “18 Tetori” Blloku “Tafil Skendo”
Kuçovë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të

Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II. Në datën 14.07.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë” me nr. Ref 20552-07-13-2017 me fond limit 199,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05.08.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë.

II.1 Në datën 19.07.2017 pala ankimuese “Higjena” sh.p.k. ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kriteret e veçanta të kualifikimit për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.1.1 Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor pala ankimuese kundërshton kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të procedurës së mësipërme të prokurimit. Në mënyrë të përmbledhur pala ankimuese ngren pretendimet se:

[...]

- i. *Së pari në sistem kemi dy emërtime të objektit “Shërbim i pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë; Pastrim i integruar i territorit të Bashkisë Kuçovë dhe edukim ambiental nëpërmjet sensibilizimit i qytetarëve. Në këto kushte këto dy emërtime, shtrohet pyetja cili do të jetë emërtimi i saktë i objektit të kontratës.*
- ii. *Zgjedhja e Marrëveshjes Kuadër në rastin konkret është e pa bazuar se në këtë lloj objekti volumet e punës dhe çdo gjë në lidhje me këtë aktivitet është e matshme dhe e planifikuar paraprakisht. Kështu që nuk ndodhemi në situata të parashikuara ku përdoret marrëveshja kuadër.*
- iii. *Fondi limit i përcaktuar nga ana juaj në masën 199,500,000 lekë pa TVSH për katër vitet e kontratës që kërkon të prokurimi dhe që për një vit është 49,875,000 lekë pa TVSH nuk përkon me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kuçovë me nr.82 datë 30.12.2016 “Për Buxhetin e vitti 2017” i cili ka miratuar një fond me 32,009,320 leke me TVSH ose 26,674,435 pa TVSH për shërbimin e pastrimit për vitin 2017. Ku jeni bazuar që keni përcaktuar vlerën vjetore dhe për katër vitet që do të prokuroni e cila është 50 % më e madhe se parashikimi i buxhetit vjetor? Gjatë vitti 2017 në Këshillim Bashkiak të Kuçovës nuk është diskutuar dhe nuk ka patur asnjë miratim për shtesë fondi për shërbimin e pastrimit. Ku e gjeni kurajon dhe mbështetjen për të shkelur ligjin nr.139/2015 “Për qeverisjen vendore” i cili në nenin 40 shprehe se ‘Kryetari i Bashkisë ose personat e autorizuar prej nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve të përcaktuara në zërin përkatës në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nesë nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla.*
- iv. *Në DST e përkatësisht në Specifikimet Teknike e Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit keni paraqitur një studim të plotë e të drejtuar dhe me analiza kostoje për pastrimin, mbledhjen e integruar të mbeturinave në Bashkinë Kuçovë për vitin 2018 si dhe shtesat për njësitë administrative për vitet në vazhdim, të realizuara nga Bashkia dhe me mbështetjen e ndihmën e USAID dhe shoqatës Lëviz Albania e financuar nga qeveria Zviceriane. Për këtë studim u aktivizuan grupe pune, qytetarë dhe veprimtarë si dhe disa nga OJQ në Bashkinë e Kuçovës të cilën monitoruan shërbimin e pastrimit*

në terren në gjithë territorin e Bashkisë si dhe u zhvilluan shumë takime e dëgjesa publike. Në konkluzionet përfundimtare të këtij aktiviteti gjithëpërfshirës ju e keni quajtur atë një arritje dhe tregues konkret për objektivat e Bashkisë për vitin 2018 e në vazhdim për pastrimin dhe mbledhjen e mbeturinave. Bazuar në këto sa më sipër edhe vlerën në lekë për shërbimin të përcaktuar nga studimi e keni konsideruar reale dhe të saktë si dhe keni përemtuar se do të bëni realitet në buxhetin e vitit 2018 për procedurën e re të tenderimit të shërbimit të pastrimit. Pra bazuar në ato që paraqitni ju, shumën e përcaktuar nga studimi nuk shkon më tepër se gjysma e fondit limit prej 199,500,000 lekë që ju doni të prokuroni. Si është përlllogaritur dhe ku bazohet shumën prej 199,500,000 lekë që ju doni të prokuroni?

- v. Ju si AK nuk keni kërkuar sipas VKM punë të ngjashme në masën 40 % të tre viteve të fundit por e keni lënë evazive duke i hapur rrugën ndonjë operatori pa eksperiencë në fushën e pastrimit, ndaj kërkojmë rishikimin e kësaj pike.
- vi. Në kriteret e veçanta ju jeni shprehur si më poshtë: Subjekti duhet të paraqesë minimalisht një bilanc të vitit të fundit fiskal, i cili duhet të jetë pozitiv. Bilanci/et duhet të jenë të audituara dhe dorëzuara në organet kompetente tatimore. Ato duhet të jenë të plota dhe të përmbajne çdo pasqyre financiare, raport, në përputhje me standartet kombëtare e ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe udhëzimet e MF. Mosparaqitja e të dhënave të kërkuara sipas këtij paragrafi është kusht për skualifikim. OE duhet të demonstrojë se raporti i debitit është me i lartë se 35% (Raporti = Debiti Total/ Asetet Total). Këto kërkesa bazuar në standartet ndërkombëtare të kontabilitetit janë paralajmërime për tregues në rënie apo negative dhe nuk ofrojnë garanci për kryerjen e shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, për detyrimet kontraktuale, për detyrimet tatimore, sigurimet shëndetësore, doganore, financiare, bankare etj. Këto të dhëna do të konsiderohen me indeks negative nga pasqyrat financiare, dhe rrjedhimisht do të skualifikohen: OE paraqet raport të leshuar nga bankat në lidhje me plotësimin e sukseshëm të detyrimeve që ka për zbatimin e kredive të marra. Rritja e stokut dhe dalja e ngadalte e tij do të konsiderohen si tregues negativë. Overdraft në rritje me xhiro vjetore statike/ të pandryshuar në rritje. Të gjitha kërkesat e mësipërme kanë dalë jashtë kornizave të kërkesave ligjore të nenit 26 VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike autoriteti kontraktor kërkon a) kopje të certifikuar të një ose më shumë bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe/ose kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Nga sa shohim më sipër ky është një kriter tepër diskriminues dhe i vendosur posaçërisht për të na përjashtuar ne si subjekt pasi në 2 vjetët e fundit kemi punuar me Overdraft nga Banka vetëm sepse ju si AK nuk na keni likuaduar në kohë për punën e kryer. Keni qenë ju si AK që na keni çuar drejt kësaj metode financimi me paaftësinë tuaj paguese për punën e kryer në dy vitet e

fundit. Për të mos lënë shërbimin pa kryer ne si OE kemi qenë të detyruar të punojmë me kredi dhe Overdraft nga banka. Edhe në VKB nr.82 datë 30.12.2016 "Për miratimin e buxheit për vitin 2017 ju kemi përcaktuar vlerën prej 26,004,731 lekë si detyrime karshi nesh si operator ekonomik për fatura të pa likujduara për punët e kryera në vitet 2015,2016 dhe që vazhdojnë të mos likujdohen edhe në këtë periudhë. Përcaktimi i kësaj procedure që kemi zgjedhur si dhe kërkesat sipas DST janë në kundërshtim dhe me nenin 28 (VKM nr.914 datë 29.12.2014) i cili shprehet se: përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet.2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.4. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveçrastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. 5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur

kanë të tilla; dhe/ose c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. 6. Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me fondin total të përlllogaritur

- vii. Në kriteret e veçanta të kualifikimit janë disa kërkesa të pa justifikuar ligjërish:
- Kërkesa e policës së sigurimit para shpërndarjes së njoftimit të procedurës është e pa llogjikshme
 - Kërkesa për një numër minimal punëtorësh në këtë procedurë për vetë vlerën dhe seriozitetin e objektit bie ndesh me disa kërkesa të tjera të cilat janë të tepruara. Kjo duhet të ishte një numër më të madh dhe vendosja e këtij kriteri është për për përcaktimin e fituesit.
 - Kërkesa për makineri është e pastudiuar mirë në lidhje me proceset e punës dhe kërkesat e kohës në përmirësimin e cilisë së shërbimit në këtë aktivitet është shumë e dyshimtë.
 - Kërkesa në paraqitjen e një kontrate me një landfill për depozitimin e mbeturinave është një kërkesë absurde. Kjo marrëveshje bëhet nga pushteti vendore në raste të tilla mbi bazën e akt marrëveshjes sepse janë pushtetet vendore administruese të këtyre landfilleve
 - Kërkesat financiare të përmendura më sipër në këtë ankesë janë jashtë kornizave dhe kërkesave të ligjit.

- viii. Në pikën 3 të kapacitetit teknik ju shpreheni se:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar vjetor i punonjësve të siguruar për periudhën : Janar-Maj 2017 duhet të jetë 25 vetë. Kjo pikë duhet të ndryshohet dhe periudha duhet të jetë 1 vjeçare për të vërtetuar numrin mesatar prej 25 punëtorëve. Mesatarja vjetore del nga 12 muaj dhe jo nga 5 muaj që ju keni kërkuar. Ky kriter favorizon operatorët e krijuar rishtaz dhe pa eksperiencë

- ix. Në kërkesat për mjetet ka një mos rakordim me specifikimet teknike sepse në preventiv ka fshirje me makineri teknologjike dhe në kërkesa nuk kërkohet makinë fshesë, mjetet teknologjike të kërkuara janë më shumë se sa duhet sipas specifikimeve teknike. Kamionat vetëshkarkues kërkohen më shumë se sa duhen referuar specifikimeve teknike. Po kështu, diskriminues është edhe viti i prodhimit të mjeteve të cilat kërkohen të jenë të vitit të prodhimit jo më poshtë se viti 2003
- x. Në VKM 914 për prokurimin publik thuhet se : “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore” Pse ju si

AK nuk keni kërkuar asnjë licencë, leje apo certifikatë për kryerjen e shërbimit, mos ndoshta dhe kjo është një pikë lehtësuese për operatorë të tjerë pretendentë pjesëmarrës dhe nuk kanë as eksperiencën dhe as licencat përkatëse, Si mund të pretendoni për shërbim cilësor dhe me standarde të larta kur formuloni këto kërkesa? Kërkojmë vendosjen e lejeve dhe licencave profesionale për këtë lloj shërbimi të cilat lëshohen nga organet kompetente.

- xi. Në DST pika 5 e Kapacitetit Teknik thuhet se : Operatori ekonomik duhet te paraqese nje akt marreveshje me nje landfill, largesia e te cilit nuk duhet te jete me e madhe se 55-km nga territori i Bashkise Kucove. Ju si AK në specifikimet teknike e keni përcaktuar saktë vendin e hedhjes së mbeturinave “Ferma Partizani” me të cilat është bërë dhe llogaritja e largësisë dhe kostoja e transportit si dhe harxhimi i karburantit. Atëherë përse duhet kjo marrëveshje. Kërkojmë që të hiqet ky kriter i pa nevojshëm dhe diskriminues
- xii. Keni kërkuar që OE te paraqese police sigurimi per pergjegjesine profesionale gjate aktivitetet tregtar per mbulimin e demeve qe mund tju shkaktohen ndaj te treteve. Kjo police duhet te jete e leshuar perpara njoftimit te procedures se prokurimit, nga nje institucion financiar, dhe duhet te mbuloje gjendjen e kapitalit te bilancit me te fundit te shoqerise ose vleren ekuivalente te demeve ne cdo rast jo me te vogel se 50,000 Euro. Vlefshmeria e policës duhet te jete minimalisht 1 vjecare, e nevojshme per te mbuluar detyrimet kontraktore dhe duhet te jete e pakufizuar numrin e demeve. Ne rast se polica eshte leshuar pas njoftimit te kontrates ajo duhet te kete vlefshmeri minimalisht 16 mujore. E pa kuptueshme kjo kërkesë si për afatin para apo mbas njoftimit të procedurës, por mbi të gjitha në kontratat që ne si OE kemi patur me Bashkinë Kuçovë që nga viti 1995 e në vazhdim për vetë llojin e shërbimit, sigurimin shëndetësor dhe të jetës nga aksidentet kemi patur për punonjësit e kompanisë edhe siguracionet e mjeteve të transportit. Kërkojmë që ky kriter të hiqet si i panevojshëm.
- xiii. Përsa i përket kriterit të vlerësimit të ofertës si Oferta Ekonomikisht më e favorshme theksojmë se duhet hequri si kriter vlerësimi sepse vetë kriteret që ju keni vendosur janë kualifikuese dhe jo opsionale. Edhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 shprehet se “ Për punët mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët. Prandaj kërkojmë që edhe ky kriter vlerësimi i ofertës të ndryshohet.
- xiv. Lidhur me edukimin publik ju keni kërkuar “Kontrata per edukimin dhe fushata sensibilizimi per qytetaret per edukimin ambiental – vlera e parashikuar per këto kontrata me nje kohëzgjatje mesatare 33 muaj secila nuk do te jete me e madhe se 20% e vlerës se kontratave per te gjitha njesite vendore (per gjithë kohëzgjatjen e tyre). Parashikohet prodhimi i 2 spoteve 31-50 sek, cdo vit, per transmetim ne 5 TV 2 kombetare, 1 publike e 2 lokale. Frekuenca e transmetimit 1 jave per secilin TV. Frekuenca, fasha orare, e te dhëna te tjera do te jene te vlerësueshme me pike. Mungesa e ofertës se spoteve apo vendosja e te dhënave (teknike dhe ekonomike) te

paqena, eshte kusht per skualifikim.” Një kriter i cili është shumë evaziv dhe zë një vlerë tepër të konsiderueshme të shumës së kontratës. I pa përcaktuar në zërat e preventivit ku i është lënë një hapësirë në të cilën mund të abuzohet lehtësisht. Ky kriter nuk është vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit, por i feshur posaçërisht nëpër DST pikërisht për të ngatërruar operatorët ekonomikë në kundërshtim me LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ku thuhet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

- xv. *Modeli i Analizave të kostos të cilat i keni publikuar në DST dhe që janë orjentuese për OE janë jo të plota dhe ngatërresë për operatorët ekonomikë. Ato duhet të jenë sa më të sakta në elementët përbërës të çdo zëri shërbimi. Në dsia analiza është përcaktuar numri i fuqisë punëtore në disa jo. Duke ju referuar tabelës së publikuar nga ana juaj në DST ju keni përcaktar çmimin për njësi të grumbullimit të mbeturinave e cila tregon pa përgjegjshmëri dhe një jo vlerësim të procedurës nga ana e njësisë së prokurimit e cila ka hartuar këto DST. Kërkojmë që analizat e kostos të saktësohen.[....]*

II.2. Në datën 21.07.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2383/2 prot datë 21.07.2017 i kthen përgjigje palës ankimuese duke pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” shpk.

II.2.1. Në kthim përgjigje autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon: “[...] Në lidhje me Ankesen tuaj të protokolluar tek ne me Nr.2383 Prot, datë 19.07.2017, në lidhje me procedurën e tenderimit me objekt: Sherbimi i Pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kucove • KSHA (Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave) vleron se ankesa e paraqitur nga operatori ekonomikë "HIGJIENA" SH.P.K ka ardhur brenda afatit zyrtarë 7 ditore të ankesave prane Autoritetit Kontraktor. Si rrjedhojë KSHA pasi mori në dispozicion dokumentacionin e nevojshëm nga njësia e prokurimit vendosi të marrë në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik "HIGJIENA" SH.P.K. OE pretendon se perzgjedhja e marreveshjes kuader është e gabuar pasi volume e punës janë të matshme dhe planifikuar paraprakisht.

- i. *Përgjigje: Në Lidhje me këte pretendim argumentimet e paraqitura nga ana e OE duket që janë dukshëm në mungesë të njohurisë dhe kuptimit të marreveshjes kuader. Ankimuesi në çdo rast I është referuar akteve nenligjore dhe në asnjë rast ligjit, që është edhe norma më e lartë hierarkike e akteve ligjore. Në asnjë moment ankimuesi nuk ka deshmuar se e ka kuptuar marreveshjen kuader duke bërë keqinterpretime apo fragmentarizime të qëllimta për të krijuar situatë të paqena.*

ii. *Perzgjedhja e marreveshjes kuader eshte tager i AK dhe jo i OE. OE nuk legjitimohet te ankimoje ne lidhje me perzgjedhjen e procedurave te prokurimit dhe perzgjedhjen e instrumentave prokuruese nga ana e AK. Ato jane nje e drejte e AK dhe perzgjedhja nga ana e AK nuk eshte parashikuar ne LPP si mundesi per ankimim. Ne cdo rast ne lidhje me ligjshmerine e perzgjedhjes, ky mbetet tager i organeve audituese ne shqyrtimet ex post, me efekte rekomanduese (ne cdo rast). AK nuk ka prokuar fonde ne kundershtrim flagrant me format dhe menytrat e parashikuara nga LPP, pasi mendesia e aplikuar nga ankimesi deshmon per mungese te thelle informacioni ne lidhje me mekanizimin e marreveshjes kuader ne rastin me te mire. Gjithesesi per te ofruar mundesine e shterimit te institutit te ankeses po japim argumentat tona si me poshte vijon: Baza Ligjore: Neni /8 perkufizon se cfare eshte nje marreveshje kuader, e cila sanksionohet edhe ne nenin 41 te VKM nr. 914 per RRPP:Marreveshje kuader" quhet nje marreveshje ndermjet nje apo me shume autoriteteve kontraktore dhe nje a 'me shume operatoreve ekonomike, qellimi i seciles eshte ti! vendose kushte te kontratave.qe do ti! prokurohen gjate nje periudhe te caktuar kohore, vecanerisht ato qe kane lidhje me r;mimin dhe.aty ku eshte e pershtatshme,me sasite e parashikuara. Neni 35/1 I LPP-se parashikon kushtet e lidhjes se nje marreveshje kuader: I .Per kontratat publike, autoritetet kontraktore mund te lidhin nje marreveshje kuader pas kryerjes se nje procedure te hapur.te kufizuar, kerkese per propozim.sherbim konsulence apo me negocim, me shpallje paraprake te njoftimit te kontrates, ndersa per kontratat sektoriale,autoritetet kontraktore mund te lidhin nje marreveshje kuader dhe pas kryerjes se nje procedure me negocim, pashpallje paraprake te njoftimit. 2.Palet ne marreveshjen kuader zgjidhen duke zbatuar kriteret e percaktimit te ofertes fituese.ne perputhje me nenin 55te ligjit. 3.Kontrata te bazuara ne nje marreveshje kuader lidhen ne perputhje me procedurat e parashtruara ne piken "5" te ketij neni .Keto procedura mund te zbatohen vetern nderrnjeteve kontraktore dhe operatoreve ekonornike, te cilet kane qene qe ne fillim pale ne marreveshjen kuader.Kur lidhen kontrata.te bazuara ne nje marreveshje kuader, palet nuk munden, ne asnje rrethane, te bejne ndryshime thelbesore te kushteve te parashtruara ne marreveshjen kuader.vecanerisht ne rastin e parashikuar ne piken Ste ketij neni. 5.Kur nje marreveshje kuader arrihet me nje operator te vetem ekonomik,kontratat e bazuara ne kete marreveshie lidhen brenda kufiive dhe kushteve te parashtruara ne marreveshien kuader.Per prokurimin e ketyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin pale ne marreveshien kuader, duke i kerkuar atii te plotesoie oferten,neperputhie me kerkesat. Ne nenin 43 te RRPP-se (VKM Nr. 914),Ndryshimi ndermjet nje marreveshjeje kuader dhe kontratave te tjera qe lidhen sipas procedurave te prokurimit te parashikuara ne LPP eshte se sasia ose kushte te tiera te mallrave/sherbimeve/puneve, qe do te prokurohen, nuk*

eshte e percaktuar ne nje marreveshje kuader. Per kete arsye, keto lloj marreveshjesh mund te perdoren kur autoritetet kontraktore e dine me siguri objektin qe do te prokurojne, por nuk dine sasine ose kushte te tiera qe do te prokurojne. Nje njarreveshje kuader eshte ligjerisht e detyrueshme per te dyja palet. Autoritetet kontraktore nuk iane te detyruara te prokuroine nie sasi te caktuar mallrash/ sherbimesh/punesh te perfshira ne marreveshie. Por, ne cdo rast gjate kohezgjaties se marreveshies kuader, autoritetet kontraktore nuk lejohen te blejne nga asnje operator ekonomik tjeter te njejtat mallra/sherbime/pune te mbuluara nga nje marreveshie kuader, pasi kjo dot e konsiderohei nje shkelie e marreveshjes. Operatoret ekonornike jane te detyruar te zbatojne kontraten sipas cilesise dhe cmimit te ofertuar, ne kohen e kerkuar prej autoriteteve kontraktore. Ne udhezimin nr. 6, dt. 27.01.2015, i ndryshuar "Qellimi i perdorimit te nje marreveshje kuader eshte zhvillimi i procedurave konkurruese te prokurimit, ne rastet kur autoritetet kontraktore dine me siguri objektin e prokurimit, por nuk dine sasine, kohen dhe/ose kushte te tjera." Pra permbladhuri sqarohet se: marreveshjet kuader jane nje instrument qe perdoren nga AK per kryerjen e sherbimeve objekt prokurimi. AK ka percaktuar sasite maksimale te sherbimeve, por per shkak se kohezgjatja e marreveshjes eshte e gjate dhe fondet buxhetore nuk jane te alokuara, AK nuk di me siguri sasine qe dote prokuroje rast pas rast, pra cdo vit per shkak te mungeses se informacionit per buxhetin. Ne rast se AK do te operoje mbi nje kontrate shumevjecare, risku per AK dote ishte i shumefishte, Bazuar ne konceptet juridike te prokurimit, ne rastin se preventivet dote prokurohen ateheredhe sasia vjetore duhet te jete e njejte e me ate te ofertes fituese duke rezultuar ne buxhete te angazhuara ne kundershtim me ligjin per sistemin buxhetor. Ne rast se AK dote prokuroje/ kontraktoje me pak sasi per shkaqe buxhetore duhet te operoje ne baze te MK. Menyra se si eshte vepruar ne te kaluaren per nga pikepamja juridike eshte e gabuar, pasi angazhon fonde buxhetore ne kundershtim me LPP. Per me teper kontratat e kaluara jane perlllogaritur ne kundershtim ne RRPP pasi nuk kane perfshire ne fondin limit vleren totale te numrit te rinovimit te kontratave te parashikuara, pasi eshte proceduar me prokurimin e fondit buxhetor te vitit kur eshte kryer procedura e prokurimit, ndersa kontratat jane shtuar ne sasi dhe ne vlere cdo vit, te cilat nuk jane perfshire ne fondin limit te prokuruar, kontrata te cilat kane cenuar vleren per para, konkurrencen duke Jene hapësira favorizuese. AK ne rastin konkret ndodhet para nje shtuate ku dimensionimi gjeografik i Bashkise ka ndryshuar ne raport me kohen kur jane lidhur kontratat e trasheguara dhe kohezgjatjet e tyre. Kuptohet qarte se ndarja apo parcelizimi i kontratave me territoret e vjetra (pra ndjekja e procedurave te prokurimit dhe lidhja e kontratave rast pas rasti me perfundimin e kontratave individuale te territoreve te ish komunave) dote cenonte sasine, vleren per para dhe konkurrencen, AK qe ne fillim te kesaj procedure prokurimi ka pasur te qarte objektin e prokurimit dhe buxhetet e alokuara deri me tani ne te kaluaren. Dhe ne asnje rast AK nuk legjitimohet te copezonte kete

procedure pasi do te ishte ne shkelje te hapur te LPP-se. Marreveshja Kuader ka si kusht mos prokurimin e sherbimeve tek nje OE tjeter pasi do te konsiderohet si shkelje e MK. Marreveshja kuader e perzgjedhur nga AK eshte ne mbeshtetje te plote te LPP-se, RRPP-se si dhe praktikave me te mira, pasi nuk angazhon fonde buxhetore, nuk angazhon fonde per buxhete te pamiratuara. Fakti qe AK ka kryer nje studim nuk do te thote qe preventivat jane te plote dhe ato duhet te prokurohen teresore. Per te zgjidhur kete risk marreveshja kuader eshte instrumenti me i pranuar bashkekohor qe mundeson zbutjen dhe eliminim e ketij risku. Preventivat sherbejne si niveli maksimal, qe do te mundesonte monitorimin e matjen e kostove dhe njekohesisht parashikimin buxhetor apo zbatimin ne varesi te fondeve te alokuara. Nuk eshte kushti i MK sasia, ai eshte nje nder elementet. Sasia bazuar ne pervojen historike ka ndryshuar ne baze te buxheteve. Dhe eshte e logjikshtre qe sasia te jete ne nivele parashikimi, pasi sipas konceptit te ankimuesit i bie qe AK te prokuroje dhe te kontraktoje sasine, duke vene ne rrezik buxhetet pasardhese, ne nje kohe qe buxheti aktual eshte i miratuar vetem per vitin buxhetor 2017. Per kete arsye MK eshte instrumenti qe lehteson dhe mundeson AK te operoje me fleksibilitet, eficence dhe efikasitet brenda buxheteve te miratuara vjetore apo PBA-se 3 vjecare, Ne cdo rast ne nje MK AK nuk eshte i detyruar te marre sasine e parashikuar pasi sasia ne kete rast eshte parashikim. AK nuk ka mundesi ligjore te parashikojte ne kontrate buxhetimin dhe tavanet buxhetor, pasi do te ishte ne kundërshtim te ligjit material buxhetor, ndersa ne nje MK buxhetimi mbetet si reference maksimale I tavan per qellime te miremanaxhimit te fondeve. Edhe ne rastet kur MK ka te parashikuara me sakte ajo mundeson perzgjedhjen e MK me nje OE sikunder kemi vepruar, pasi same shume pasiguri apo mangesi ne informacion dote ndikojne ne llojin e MK. Ne rastin konkret AK ka percaktuar teresine e kushteve te mundshme perpos buxhetit por qe eshte manaxhuar ne nivele te kenaqshme ligjore duke perzgjedhur MK me nje OE por duke operuar ne MK pasi vetem ne MK sasite mund te ndryshojne ne varesi te buxhetit dhe jo sikunder eshte operuar deri me tani.

- iii. Kemi dy emertime objekti , cili do te jete emertirni I sakte: a. Ne lidhje me te paren eshte e mertesa e procedures se prokurimit per DST, ndersa objekti I MK eshte ai percaktuar ne njoftimin e kontrates qe eshte percaktuar qarte: Pastrim i integruar I territorit te Bashkise Kucove dhe edukim ambiental nepermjet sensibilizimit te qytetareve. Nuk shohim perplasje pasi e para eshte nje detajim i proceseve te punes.
- iv. Ne lidhje me seksionin 4.1: keni te drejte pasiper shkak te nje gabimi material. Pra eshte procedure e hapur. Ne cdo rast OE nuk mund te gabohen pasi te dhenat e procedures jane te mire percaktuara sine DST, ne sistemin e prokurimit elektronik dhe ne njoftimin e kontrates, pra kemi te bejme me nje gabim material lehtesisht te korrigjueshem.

- v. *Ne lidhje me studimin Autoriteti Kontaktor nuk ka asnje detyrim ligjore qe ti vere ne dispozicion Operatoreve Ekonomik informacion qe se kush e ka ralizuar kete studim. a. Ne lidhjen me fondin limitjane mbledhur teresia e kontratave te parashikuara ne kalendarin e MK per kohezgjatjet maksimale. Kujtojme se sasite e preventivave jane vjetor dhe nuk permbajne te dhena te tjera si edukimi qytetar, etj ne kete studim. OE ne perputhje me kushtet dhe kerkesat e tenderit duhet te paraqese oferten e tij teknike dhe ekonomike per te ofertuar. OE parashtron ankesen mbi bazen e nje moskuptimi qe e ben kete ankese te paargumentuar. OE duhet te beje identifikimin ne lidhje me kete pike nese eshte i paqarte apo ankimon ne lidhje me shkeljen e nje dispozite. Kujtojme se fondi limit ne rastin konkret parashikohet per nje periudhe qe mbulon kohezgjatjen e MK dhe kontratave individuale ne pergjithesi.*
- vi. *Ne lidhje me kriteret e vecanta per kualifikim, subjekti ankimues nuk ka paraqitur asnje pretendim ne lidhje me kriteret e percaktuara ne seksionin 3.2. OE shprehet se kerkesat e vendosura ne DST ne mbeshtetje te ketij neni dalin ne disa raste jashte kornizave ligjore. OE nuk ka percaktuar se cilat jane komizat ligjore qe preken nga keto kerkesa dhe impakti i tyre. Perkundrazi teresia e kerkesave parashikon mundesine e vleresimit ne menyre objektive te ofertave duke percaktuar qartesisht treguesit qe do te vleresohen ne keto dokumente dhe duke evituar subjektivitetin apo lejimin e mundesive per perdorimin e kriterëve qe nuk jane percaktuar ne DST. Kerkesa jane te bazuara ne praktikat me te mira nderkombetare dhe vleresojne ne teresi, nepermjet nje analize financiare kapacitetet e ofertuesit per Kapacitetin (aftesine per te levruar), aftesine (per standartet e zbatueshme) dhe shkallen e dependences nga nje kontraktor.*
- vii. *Kriteri: overdraft ne rritje me xhiro vjetore statike/ te pandryshuar ne rritje sherben per te deshmuar shendetin financiar dhe besueshmerine e OE, qe operojne ne baza te besueshme tregtare dhe te mos sherbejne si OE qe operojne me kontrata dhe ne pamundesi per te justifikuar shpenzimet e bera. Vleresimi ketij kriteri behet nepermjet disa elementeve kryesore te bilancit. Nje OE qe injekton para, ka detyrime financiare dhe nderkohe shpenzimet jane ne vlera minimale, eshte tregues qe keto para nuk jane perdorur ne sherbim te qellimit. Keto elemente qe permendem me siper jane sinjale paralajmruese financiare. Argumentat qe ju jepni mbeten pjese e nje procesi vleresimi te dyfishte ndermjet OE dhe kontraktorit. Vonesat ne pagesa mund te duken argument i logjikshem por vleresimi i pretendimeve tuaja behet ne nje kendveshtrim me te gjere jo vetem financiar por edhe ne raport me cilesine, strandartet e zbatuara dhe modus operandi. Pretendimet tuaja duhet te kene baze ligjore, dhe argumenta shkencor apo bazuar ne praktika, te mbeshtetura ne dokumenta te cilat ju nuk i keni paraqitur. Keto pretendime mund te bien ndesh me realitetin pasi pagesa e AK varet nga nje sere faktoresh si cilesia e sherbimit, perputhshmeria me kushte e kontrates, etj. AK ne asnje rast nuk ka pasur mundesine e disponimit te bilanceve (mete fundit financiare) te OE dhe tuajen. Per*

me teper AK nuk ka kryer nje procedure prokurimi te koheve te fundit ku ju te keni ofertuar dhe te keni dorezuar dokumentacionin e kerkuar. Kerkesat jane vendosur mbi baza te llogjikes financiare per te zbatuar dhe ushtruar objektivet bazuar ne parimin e barazise dhe jo te favorizimit te subjekteve. Ju si ankimues qenkeni te mireinformuar ne lidhje me ceshtjet e brendshme administrative, nderkohe qe ju sqarojme se ne Marrveshjen Kuader buxheti qe prokurohet nuk angazhohet, pasi jane kontratat individuale ato qe angazhojne fonde buxhetore dhe cdo veprim IAK ka gene ne perputhje me LPP-ne. Ne rast se ju keni shqetesime ne lidhje me menyren se si operojne organet administrative publike, mund te ushtroni te drejten tuaj per te kerkuar informacion ne perputhje me legjislacionin perkates.

- viii. OE pretendon se kerkesat e vendosura ne disa raste dalin jashte kornizave ligjore, por ne asnje moment ankimuesi nuk ka deshmuar qarte se cilen kornize ligjore tejkalojne keto kerkesa. Ne nenin 28 te VKM Nr. 914, pika i jep te drejten AK te kerkoje bilancet me qellim njohjen e gjendjes financiare dhe te mundesise se tyre per te permbushur me sukses marreveshjen/ kontraten. Por kerkesa e bilanceve nuk eshte nje kerkese binarike. AK duhet te tregojte qe ne fillim te procedures se cfare elemente te bilancit dote vleresojte pasi ne rast se nje OE paraqitet me bilance mete dhena alaramante apo negative nuk do te mund te marre nje vendim ne rast se nuk ka treguar elementet qe do te vleresojte pasi do e vendoste AK ne kushte diskriminuese dhe favorizuese.
- ix. Ne lidhje me kerkesen e policies se sigurimit. Ky kriter ka te beje me garantimin dhe besueshmerine e subjekteve. Ne rast se nje subjekt e disponon kete police, duhet te marre masa qe te jete ne perputhje me afatet e kerkuara per te deshmuar se ofron vijimesine e besueshmerise. Ky eshte nje element kyç per te vleresuar, bazuar ne LPP si dhe ne praktikate evropiane, aftesine ekonomike dhe financiare te kandidatave pasi operojne ne nje treg ku cilesia e punes se tyre mund te demtoje shendetin e publikut dhe aftesite e tij financiare behen insolvente qofte edhe me nje padi te thjeshte civile. Mbulimi i ketij risku nga nje kompani sigurimi e ben te manaxhueshem kete risk, dhe si i tille duhet vleresuar para dhenies se MK.
- x. Ne lidhje me numrin e punonjesve. Ne te vertete nurnri i punonjesve nuk eshte kusht thelbesor pasi cdo OE i pershtat aftesite e tij teknike dhe njerezore ne perputhje me volumin e angazhimeve te marra persiper. Ky numer mund te jete edhe me i vogel pasi bazohet ne nenin 46, pika 3 te LPP-se ku inkurajohen AK qe te stimulojne pjesmarrjen e biznesit te vogel e te mesem. Ne kete rast OE mund te kontraktojte punetore me shume, pasi kemi te bejme me nje marreveshje kuader ku sasia e sherbimeve nuk eshte e garantuar per shkak te disponibilitetit te fondeve dhe behet nje ngarkese e padrejte ndaj OE te kualifikuar dhe qe kane teresine e elementeve qe e lejojne te marrin pjese ne procedura prokurimi. Numri i punonjesve per nje periudhe te caktuar nuk eshte kusht dhe kriter pasi kemi te bejme me nje shtrirje graduale te sherbimeve te pastrimit ne territorin e bashkise kuqove. Ne kete rast nuk gjeme asnje element qe te percaktojte fituesin pasi perkundrazi zgjerohet

konkurrenca dhe njekoheisht ofertat mund të jenë konkurruese. Në lidhje me periudhën që kërkohej kjo kërkesë do të merret parasysh dhe nga Janar-Maj dote behet Qeshor 2016-Qeshor 2017.

- xi. Në lidhje me pretendimin se kërkesa për makineri është e pastudiuar, dhe e dyshimite OE nuk ka paraqitur asnjë argument dhe si e tillë nuk mund të vlerësohet. theksojmë se AK ka kërkuar që OE të bëjë një plan investimi dhe se kërkesa e makinerive është minimum i mundshëm që duhet të ketë një subjekt që operon në këtë fushë. Plani i investimit do të jetë objekt vlerësimi pasi do të pasqyrojë teresinë e mjeteve të angazhuara nga ana e subjekteve. Pra heqja e barrierave artificiale për konkurrencën e bën këtë procedurë me të hapur pasi subjektet mund të paraqesin alternativat e tyre të cilat në asnjë rast nuk bienin pasi mbeten në proces vlerësimi dhe në këtë mënyrë vlerësohet oferta me e mirë, jo vetëm në terma financiar por edhe teknike.
- xii. Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e një kontrate me një landfill, ankimesi e vlerëson si absurd. OE nuk ka paraqitur asnjë argument për të vertetuar këtë absurditet. AK në kuptim të teresisë së jurisprudencës së mbrojtjes së mjedisit dhe evadimit të mbetjeve të ngurta duhet të deshmojë se kanë zbatuar legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe kanë si qëllim për të zbatuar këtë marrëveshje kuader duke paraqitur një marrëveshje me një landfill. Kjo kërkesë nuk është aq e absurde por perkundrazi është një dëshmi për zbatimin e ligjit ambiental. Mungesa e një marrëveshjeje të tillë dote cenonte zbatimin me sukses të kontratave të ndryshme Brenda MK dhe do krijonte hapesira për cenimin e ruajtjes së ambientit duke inkurajuar kompani që ndosin ambientin apo operojnë jo në përputhje me standartet ligjore për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit.
- xiii. Në lidhje me numrin e mjeteve ankimesi pretendon se mjetet duhet të jenë me të vjetra, që demtojnë ambientin në një kohë që raporti i makinerive me preventivin nuk janë të mbingarkuara. Numri i makinerive në çdo rast është minimumi i mundshëm pasi OE mund të japë oferte teknike dhe ekonomike në përputhje me kërkesat e tenderit. Kujtojmë se është një procedurë ku vlerësimi behet bazuar në kriterin MEAT, dhe makineritë e kërkuara janë minimalet e mundshme për të ofruar një shërbim minimal, ndërsa oferta teknike dote elaborojë teresinë e zgjidhjes që dote ofrojnë ofertuesi duke plotësuar kërkesat e tenderit, specifikimet teknike dhe kushtet e tjera. Pra në këtë rast AK nuk kërkon një subjekt që plotëson minimumin e cilesisë së shërbimit por duhet të deshmojë se si ky ofertues dote angazhohet për një cilësi më të mirë shërbimi, qoftë nëpërmjet investimeve, apo zgjidhjeve teknologjike më të pershtatshme.
- xiv. Në lidhje me licencat, bazuar në kushtet e përgjithshme të kontratës licencat nxirren edhe pas lidhjes së MK. Në rastin konkret ky shërbim nuk ka si domosdoshmëri pajisjen me licence, për aktivitetet kryesore të kërkuara.
- xv. Në marrëveshjen kuader specifikimet teknike janë subjekt ndryshimi. Fakti që aktualisht AK ka parashikuar nuk dote thote që përgjate gjithë jetëgjatësinë së MK

do te operoje ne kete menyre. Per me teper kjo specifike nuk eshte ndryshim i mirefillte i specifikimve teknike pasi ka te beje me nje process pune qe AK parashikon ta kaloje tek lendfille Brenda distances se kerkuar. Pra OE ofertues duhet te beje dorezim te mbetjeve ne landfilleve Brenda nje distance te percaktuar ne DT.

- xvi. Ne lidhje me kriteret e vleresimit ato jane te bazuara ne nenin 55 i cili parashikon se [oferta ekonomikisht me e favorshme, aplikohet: "bazuar ne kriteret te ndryshme telidhura me objektin e kontrates qe prokurohet.si.cilesia.cmimi.cilesie teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kosto le funksionim it, efektshmeria ekonomike, sherbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudhae levrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht qe keto kriteret te jene objektive dhe jodiskriminuese" ne rastin konkret AK ka kerkuar oferta teknike me zgjidhje mbi minima/en qe ndikojne ne jeten e perditshme te qytetareve, si dhe jane te kombinuara me nje sere elementesh te tjere si edukimi qytetar, makineri, zgjidhje teknike qe nuk mund te vleresohen me kriterin cmimi me i ulet. Perkundrazi kriteri per edukimin qytetar jane kriteret qe bazuar ne legjislacionin ne fuqi behen bazuar me pike.
- xvii. Ne lidhje me pretendimin se kjo kerkese eshte evasive nuk qendron. Kerkesat jane te qarta dhe bazuar ne legjislacionin ne fuqi ato jane te percaktuara qarte se si operohet. Ky eshte nje element qe ka te beje me edukimin qytetar i ambiental dhe nuk eshte kusht per te vertetuar kapacitetet e operatorit. Per kete arsye ofertuesit duhet te paraqesin ne ofertën e tyre edhe kete kerkese e cila ka peshen e vet te vleresimit sipas faktorizimit te perqindjes se pikeve (peshes se ofertes). OE duhet te paraqese nje strategji qe dote vleresohet me pike, pasi kemi te bejme me nje larmisherit te madhe te mediave te komunikimit public ku alternative e sherbimeve dhe target grupeve vleresohen me pike sipas percaktimeve te bera ne njoftimin e kontrates. Kriteret e vecanta per kualifikim nuk kane lidhje me permbajtjen e ofertes pasi ato percaktohen ne OT ndersa aftesite teknike jane ato qe i nenshtrohen procesit te vleresimit ne seksionin e kriterëve te vecanta per kualifikim. Edhe ne kete rast kjo kerkese mbetet e pambeshtetur.
- xviii. Ne lidhje me modelin e analizës se koston jane orientuese dhe jane hartuar nga struktura pergjegjese ne AK, jo nga NJP. OE ne baze te ofertes se tij dote paraqese analizen e tij. Modeli i analizave permban minimumin e te dhenave qe dote jape OE, por ne varesi te zgjidhjes do te plotesoje kete analize kosto me te dhenat e plotate ofertes se tij (Parimi i proporcionalitetit). Pasi AK ka asnje te drejte qe te diktoje modelin e koston ne nje kohe qe zgjidhja teknike mund te ndryshoje nga ajo e sugjeruar nga AK, apo zgjidhja permban karakteristika teknike me te mira se ato te AK.
- xix. Pretendimet e ankimesit ne lidhje me piken e fundit nuk qendrojne per arsye se procedura eshte e bazuar ne ligj. Kete dhena te sakta e te kuptueshme ne teresine e tyre pasi perben bazen e te dhenave me te cilen ky subject ka operuar deri me tani.

Nuk shkel asnje ligj perkundrazi eshte ne perputhje me teresine e legjislacionit ne fuqi dhe ofron pjesmarrje te gjere te OE, pasi bazohet ne parimin e proporcionalitetit.

II.3. Në datën 28.07.2017 pala ankimuese ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor.

II.4. Në datën 18.08.2017 autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumenta cionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar parashtrimeve me shkrim të ankimuesit para autoritetit kontraktor dhe para Komisionit të Prokurimit Publik, ky i fundit ka parashtruar pretendime si në drejtim të procedurës së përzgjedhur nga ana e autoritetit kontraktor, kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi si edhe kërkesën në lidhje me shtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit. Në lidhje me kërkimet e fundit, KPP konstaton se ankimuesi ka parashtruar pretendime në lidhje me shtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimi veçanërisht në drejtim të përcaktimit në këto të fundit të kërkesave lidhur me dëshminë e eksperiencës së mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit, kërkimin mbi shtimin e kërkesave në lidhje me licencat e shoqërive pjesëmarrëse për zbatimin e kontratës si edhe kërkesa mbi rritjen e fuqisë punëtore të kërkuar duke pretenduar se numri minimal prej 25 punonjësish dhe periudha e kërkuar nuk është në përpjestim me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme, KPP konstaton se ankimuesi në mënyrë të përmbledhur argumenton se “i. Ju si AK nuk keni kërkuar sipas VKM punë të ngjashme në masën 40 % të tre viteve të fundit por e keni lënë evazive duke i hapur rrugën ndonjë operatori pa eksperiencë në fushën e pastrimit, ndja kërkojmë rishikimin e kësaj pike. ii. Kërkesa për një numër minimal punëtorësh në këtë procedurë për vetë vlerën dhe seriozitetin e objektit bie ndesh me disa kërkesa të tjera të cilat janë të tepruara. Kjo duhet të ishte një numër më të madh dhe vendosja e këtij kriteri është për përcaktimin e fituesit. iii. Në VKM 914 për prokurimin publik thuhet se : “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore” Pse ju si AK nuk keni kërkuar asnjë licencë, leje apo certifikatë për kryerjen e shërbimit, mos

ndoshta dhe kjo është një pikë lehtësuese për operatorë të tjerë pretendentë pjesëmarrës dhe nuk kanë as eksperiencën dhe as licencat përkatëse, Si mund të pretendoni për shërbim cilësor dhe me standarde të larta kur formuloni këto kërkesa? Kërkojmë vendosjen e lejeve dhe licencave profesionale për këtë lloj shërbimi të cilat lëshohen nga organet kompetente.” Si edhe shtimin e mjetit tip autofshesë në listën e mjeteve të kërkuara. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 12 pika 1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij”*

Në nenin 19/1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj”*

Në nenin 63 pika 1 dhe 1.1 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar parashikohet se:

Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:

- a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;*
- b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;*
- c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;*
- ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.*

III.1.2. Në nenin 28 pika 1 dhe 2 të Vendimit nr. 184, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar” parashikohet se :

1. Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar:

a) Pushimin e procedimit administrativ për shkak se veprimet e treguara në ankesë nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit mbi prokurimin publik apo kur pretendimet e ankuesit rezultojnë të paprovuara; ose

b) Ndalimin e autoritetit kontraktor të vazhdojë veprimet e paligjshme, duke i caktuar një afat kohor.

2. Nëse Komisioni vendos sipas pikës 1 shkronjës “b” të këtij neni me arsyetimin se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me ligjin 9643/2006, dhe kontrata e prokurimit ende nuk është lidhur, atëherë Komisioni ka të drejtë:

a) Të interpretojë rregullat ose parimet ligjore që duhet të zbatohen për objektin e ankesës, duke udhëzuar autoritetin kontraktor të veprojë sipas këtij interpretimi në vazhdimin e procedurës së prokurimit;

b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim;

c) Të konstatojë shkeljen ligjore konkrete dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor mbi korrigjimin e tyre, si dhe për vazhdimin e procedurës së prokurimit;

d) Të anulojë procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit.

Në nenin 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se : “ Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:

- sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;

- përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);

- përllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin e urdhrin të prokurimit;

- përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;

- hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;

- administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;

- llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”

III.1.3. Referuar metodës së interpretimit sistematik (*domethenjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik*), Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ka një ndarje të qartë mes rolit të tij të paraparë nga ligji si organi më i lartë i shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike (neni 19/1 e vijues i LPP-së) dhe autoriteteve kontraktore si organ përgjegjës i zhvillimit të procedurave të prokurimit (neni 12 i LPP-së) dhe njëherazi përgjegjës për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik. Në nenin 63 pika 1.1. të LPP-së, parashikohet se “*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.*” KPP gjykon se, që të justifikohet ligjërisht kërkimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar duhet që të bëhet vetëm prej atij që i përket, sipas ligjit, e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti dhe vetëm kundër atij që me faktin ose me veprën e tij mohon ose shkel të drejtën e kërkuesin (legjitimimi pasiv), duke justifikuar me këtë fakt ose veprim ndërhyrjen e organit administrativ për të ndaluar ose për të zhdukur dëmin e rrjedhur nga ky fakt, ose veprimeve (*legitimation ad causam*), pra operatori ekonomik ankimes duhet të provojë se interesi i tij i ligjshëm është cënuar nga vendime dhe veprime konkrete (reale) të autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar mekanizmat ligjorë për kundërshtimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit pranë këtij të fundit, duke dhënë garanci të plota operatorëve ekonomikë ankimes se procedurave për fitimin e kontratave publike, do të nënshtrohet kushteve specifike (kriterëve të veçanta të kualifikimit), të cilat duhet të përmbushin parakushtin *sine qua non* të parashikuar nga neni 46 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, duke qenë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese. Në rastin konkret, KPP gjykon se njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor ka parashikuar kriteret minimale kualifikuese, të gjykuar të nevojshëm për vërtetimin e plotësimit të kapacitetit teknik të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi. Kuadri ligjor në fuqi, ka paraparë pozitën juridike të Komisionit të Prokurimit Publik, si organ i shqyrtimit të ankesave kundër vendimeve të shprehura me akte administrative (dokumentet e procedurës së prokurimit) duke i dhënë të drejtën ligjore të shprehet mbi kriteret kualifikuese dhe specifikimet teknike në rast se këto të fundit janë hartuar në përputhje me ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, të ndryshuar dhe kuadrin ligjor sektorial në fuqi që rregullon kontratën objekt prokurimi. Kompetenca e mësipërme është shprehur në disa drejtime në ligjin për prokurimin publik në fuqi, ku nën nenin 63 pika 4 gërma “b” të *lex specialis* parashikohet se ndër kompetencat e Komisionit të Prokurimit Publik janë ato të anulimit, plotësisht ose pjesërisht, një veprimi ose vendimi të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës,

apo në rast se specifikimet teknik janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kriterëve kualifikuese në një procedurë prokurimi. Sa më sipër, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia procedurale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.2. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe trajtimit të kësaj të fundit nga komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, konstatohet se ky i fundit ka pranuar pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik ankimes në lidhje me disa prej kërtimeve të këtij të fundit.

III.2.1. Në nenin 63 pika 1.1 të *lex specialis* ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”

III.2.2. Në nenin 63 pika 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve¹⁴⁰ nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”

III.2.3. Referuar aktit administrativ nr.2383/2 prot datë 21.07.2017 i trajtim i ankesës së ankimuesit, autoriteti kontraktor ka pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” shpk. Konkretisht, referuar aktit të mësipërm, KPP konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor janë pranuar kërkimet e operatorit ekonomik ankimes në lidhje me emërtimin e procedurës së

prokurimit, llojit të procedurës së prokurimit referuar seksionit 4.1. të dokumenteve të procedurës së prokurimi objekt ankimi, si edhe mbi modelin e analizës së kostos. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, KPP konstaton se megjithëse Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i ngritur pranë autoritetit kontraktor ka vendosur pranimin e pjesëshëm të ankesës së operatorit ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e sipërcituara, nga ana e autoritetit kontraktor nuk janë reflektuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike ndryshime (shtojcë e dokumenteve të procedurës së prokurimit) në lidhje me vendimarrjen e K.Sh.A. Megjithatë, Komisioni i Prokurimit Publik nuk mund të anashkalojë faktin se kërkimet e mësipërme janë pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe në lidhje me këto të fundit nuk ka më objekt ankimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, por në zbatimin e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor, krahas konstatimeve të vendimarrjes së K.P.P. duhet të pasqyrojë njëherazi edhe ndryshimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit për aq sa është pranuar nga njësia e shqyrtimit të ankesave e ngritur brenda autoritetit kontraktor.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik në lidhje me përzgjedhjen nga ana e autoritetit kontraktor që në përfundim të procedurës së prokurimit të lidhet marrëveshje kuadër me një operator ekonomik të vetëm, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në seksionin 2.1.2 dhe 2.1.3. të “Objektit të Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur marrëveshjen kuadër me “një operator të vetëm ekonomik”. Gjithashtu, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit, kohëzgjatja e kontratës është parashikuar 4 vjet.

III.3.2. Në nenin 3, pika 8/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: “ *Marrëveshje kuadër*” quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një a më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave, që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara”

Në nenin 35/1 “Marrëveshjet kuadër” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se:

“ 1. Për kontratat publike, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër pas kryerjes së një procedure të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence apo me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, ndërsa për kontratat sektoriale, autoritetet kontraktore mund të lidhin një marrëveshje kuadër edhe pas kryerjes së një procedure me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit.

2. Palët në marrëveshjen kuadër zgjidhen duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të ligjit.
3. Kontratat e bazuara në një marrëveshje kuadër lidhen në përputhje me procedurat e parashtruara në pikat 5 e 6 të këtij neni. Këto procedura mund të zbatohen vetëm ndërmjet enteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë, të cilët kanë qenë që në fillim palë në marrëveshjen kuadër. Kur lidhen kontrata, të bazuara në një marrëveshje kuadër, palët nuk mundin, në asnjë rrethanë, të bëjnë ndryshime thelbësore të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, veçanërisht në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni.
4. Kohëzgjatja e një marrëveshjeje kuadër nuk mund të jetë më e gjatë se katër vjet, përveç rasteve të jashtëzakonshme, plotësisht të justifikueshme, në veçanti nga subjekti i marrëveshjes kuadër.
5. Kur një marrëveshje kuadër arrihet me një operator të vetëm ekonomik, kontratat e bazuara në këtë marrëveshje lidhen brenda kufijve dhe kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër. Për prokurimin e këtyre kontratave, autoriteti kontraktor komunikon me shkrim me operatorin palë në marrëveshjen kuadër, duke i kërkuar atij të plotësojë ofertën, në përputhje me kërkesat.
6. Kur një marrëveshje kuadër lidhet me disa operatorë ekonomikë, këta të fundit duhet të jenë, të paktën, tre, në numër, për sa kohë që ekziston një numër i mjaftueshëm operatorësh ekonomikë, për të përmbushur kriteret e përzgjedhjes dhe/ose të pranimit të ofertave, që përmbushin kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, në përputhje me nenin 55 të ligjit. Kontratat e bazuara në marrëveshjet kuadër, të arritura ndërmjet disa operatorëve ekonomikë, mund të lidhen në një nga këto mënyra:
- a) nëpërmjet zbatimit të kushteve të parashtruara në marrëveshjen kuadër, pa rihapur konkurrimin;
- b) kur jo të gjitha kushtet janë të parashtruara në marrëveshjen kuadër, kur palët gjenden sërish në konkurrim, sipas të njëjtave kushte dhe, nëse është e nevojshme, në bazë të kushteve të formuluar më saktësisht dhe aty ku kjo është e përshtatshme, kur parashikohen kushte të tjera në specifikimet e marrëveshjes kuadër, në përputhje me procedurën në vijim:
- i) për çdo kontratë, që do të prokurohet, autoritetet kontraktore duhet të këshillohen, me shkrim, me operatorët ekonomikë, që janë në gjendje të zbatojnë kontratën; ii) autoritetet kontraktore duhet të caktojnë një kufi kohor, të mjaftueshëm për dorëzimin e ofertave, për secilën kontratë specifike, duke marrë parasysh kompleksitetin e objektit, që do të prokurohet, dhe kohën e nevojshme për të dorëzuar ofertat; iii) ofertat do të dorëzohen me shkrim dhe përmbajtja e tyre duhet të mbetet konfidenciale, derisa kufiri i përcaktuar kohor për përgjigje të ketë skaduar; iv) autoritetet kontraktore do t'ia japin secilën kontratë ofertuesit, që ka dorëzuar ofertën më të mirë, në bazë të kriterëve të shpalljes së kontratës fituese, të përcaktuara në specifikimet e marrëveshjes kuadër.
7. Autoritetet kontraktore nuk mund t'i keqpërdorin marrëveshjet kuadër për të penguar, kufizuar apo çrregulluar konkurrencën.
8. Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik.”

III.3.3. Rregullimet e posaçme mbi aplikimin e marrëveshjes kuadër, parashikon në aktin nënligjor në zbatim të ligjit, Vendimin nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të posaçme të prokurimit publik”, të ndryshuar, në të cilën në nenet 41 e vijues parashikohet si më poshtë vijon:

“Neni 41

Përkufizimi i marrëveshjes kuadër

Marrëveshje kuadër quhet një marrëveshje ndërmjet një apo më shumë autoriteteve kontraktore dhe një apo më shumë operatorëve ekonomikë, qëllimi i së cilës është të vendosë kushtet e kontratave që do të prokurohen gjatë një periudhe të caktuar kohore, veçanërisht ato që kanë lidhje me çmimin dhe, aty ku është e përshtatshme, me sasinë e parashikuara.

Neni 42

Palët në marrëveshjen kuadër

1. Një marrëveshje kuadër mund të lidhet ndërmjet:

a) disa autoriteteve kontraktore dhe disa operatorëve ekonomikë;

b) disa autoriteteve kontraktore dhe një operatori ekonomik;

c) një autoriteti kontraktor dhe disa operatorëve ekonomikë.

2. Autoritetet kontraktore që kanë për qëllim të lidhin një marrëveshje kuadër duhet të përcaktohen në njoftimin e procedurës së prokurimit. Nuk është e lejueshme të përdorin një marrëveshje kuadër autoritetet kontraktore, të cilat nuk janë palë e marrëveshjes kuadër.

Të gjithë operatorët ekonomikë, që janë pjesë e marrëveshjes duhet të listohen në marrëveshje dhe nuk është e lejueshme të pranohen operatorë ekonomikë të tjerë në marrëveshje, pas përfundimit të procesit të prokurimit.

Neni 43

Qëllimi

Ndryshimi ndërmjet një marrëveshjeje kuadër dhe kontratave të tjera që lidhen sipas procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP është se sasia ose kushte të tjera të mallrave/shërbimeve/punëve, që do të prokurohen, nuk është e përcaktuar në një marrëveshje kuadër. Për këtë arsye, këto lloj marrëveshjesh mund të përdoren kur autoritetet kontraktore e dinë me siguri objektin që do të prokurojnë, por nuk dinë sasinë ose kushte të tjera që do të prokurojnë.

Autoritetet kontraktore mund të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.

Neni 44

Detyrimet që rrjedhin nga marrëveshja kuadër

Një marrëveshje kuadër është ligjërish e detyrueshme për të dyja palët. Autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të prokurojnë një sasi të caktuar mallrash/shërbimesh/punësh të përfshira në marrëveshje. Por, në çdo rast gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kuadër, autoritetet kontraktore nuk lejohen të blejnë nga asnjë operator ekonomik tjetër të njëjtat mallra/shërbime/punë të mbuluara nga një marrëveshje kuadër, pasi kjo do të konsiderohej një shkelje e marrëveshjes.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të zbatojnë kontratën sipas cilësisë dhe çmimit të ofertuar, në kohën e kërkuar prej autoriteteve kontraktore.

Neni 45

Prokurimi i marrëveshjes kuadër

1. Marrëveshja kuadër prokurohet sipas këtyre rregullave. Ajo mund të lidhet vetëm pasi autoritetet kontraktore të kenë kryer një procedurë të hapur, të kufizuar, kërkesë për propozim, shërbim konsulence ose me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Në kontratat sektorale autoritetet kontraktore mund të përdorin gjithashtu procedurën me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë përzgjidhen si palë të marrëveshjes kuadër duke zbatuar kriteret e përcaktimit të ofertës fituese, sipas përcaktimeve të nenit 55 të LPP. Në çdo rast, autoriteti kontraktor mund të vendosë të vlerësojë ofertën/ofertat fituese duke u bazuar në çmimin për njësi.

Në rastin kur objekt i marrëveshjes kuadër janë biletat e transportit ajror ndërkombëtar, në vend të çmimit do të përdoret marzhi i fitimit i shprehur në përqindje.

3. Autoriteti kontraktor harton dhe publikon njoftimin e fituesit për një marrëveshje kuadër në përputhje me LPP dhe këto rregulla.”

III.3.4. Referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shtojcën mbi specifikimet teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit janë parashikuar natyra e shërbimit të kërkuar, por njëkohësisht edhe volumi i shërbimit për proceset e parashikuara nga ana e autoritetit kontraktor. Konkretisht Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor në lidhje me zërin *Fshirja me fshese dorë në rrugë, sheshe dhe trotuare në të gjithë qytetin e Kuçovës* janë parashikuar të dhëna të sakta për të gjithë zonën e mbulimit të shërbimit, emërtesat e rrugëve, shesheve, numrin e tyre si edhe sipërfaqen korresponduese të shesheve, rrugëve trotuareve, të ndara në lagje si edhe në mënyrë analitike për secilën rrugë të parashikuar. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka parashikuar edhe sheshet, rrugët për të cilat është kërkuar ofrimi i shërbimit të pastrimit me mjete teknologjike autofeshesë në të cilën janë përcaktuar dhe pasqyruar përmasat e rrugëve si edhe sipërfaqja totale e kërkuar për ofrimin e shërbimeve. Gjithashtu në lidhje me preventivat e shërbimit, autoriteti kontraktor ka parashikuar preventiva me sasi të plotë si edhe sqaruar me komente mbi shtimin e volumeve për secilin

vit, duke nisur nga viti 2017 viti 2018 dhe viti 2019. Konkretisht, KPP konstaton se nga ana e autortetit kontraktor janë parashikuar preventivat si më poshtë vijon:

Viti 2017 e ne vijim

<i>Nr.</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi /njesi</i>	<i>Dite pune/vit</i>	<i>Vlera</i>
1.	<i>Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve</i>	<i>m²</i>	<i>161 000</i>		<i>312</i>	
2.	<i>Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve</i>	<i>“</i>	<i>32 000</i>		<i>52</i>	
3.	<i>Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)</i>	<i>ton</i>	<i>19,7</i>		<i>312</i>	
		<i>cope</i>	<i>253</i>			
4.	<i>Larja e konteniereve metalike</i>	<i>“</i>	<i>60</i>		<i>48</i>	
5.	<i>Sherbimi i pastrimit ne EC-te publike te qytetit</i>	<i>“</i>	<i>4</i>		<i>312</i>	
6.	<i>Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik</i>	<i>m²</i>	<i>73 000</i>		<i>220</i>	
7.	<i>Hegja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit</i>	<i>dite</i>	<i>312</i>		<i>312</i>	
8.	<i>Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”</i>	<i>“</i>	<i>312/120</i>		<i>216</i>	
	<i>Shuma</i>					
	<i>TVSH 20%</i>					
	<i>Shuma totale</i>					

V.O Per vitin 2017, ditët e punës do te përpjesëtohen ne raport me periudhën e mbetur te vitit 2017.

PREVENTIV

Viti 2018 – shtese e punimeve vjetore te parashikuara ne preventivin e mësipërm vjetor

Per sherbimin e pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane per bashkine Kucove (shtese qyteti Kucove dhe njesia Kozare).

Buxheti i priteshem:

- 4 502 890 leke (pa tvsh)

Viti 2018 – shtese:

- rruge qe fshihen me fshese dore – 10 rruge – me sipërfaqe 33 400 m²- (312 dite pune/vit)

- rruge qe fshihen me autofshese – 3 rruge – me sipërfaqe 11 300 m² – (52 dite pune/vit)

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi/ njesi	Dite pune/vit	Vlera
1.	Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	33 400		312	
2.	Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve	“	11 300		52	
3.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	ton cope	2,9 30		104	
4.	Larja e konteniereve metalike	“	45		12	
5.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	12 000		220	
6.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	104		104	
7.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”	“	104		104	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

- grumbullim + transportim i mbeturinave urbane – 2,9 ton/dite – 30 kont/dite - (104 dite/vit)
- larje e konteniereve metalike – 1 larje/kontenier/muaj (45 kont/dite.) – ose 12 dite/vit
- lagije e rrugeve e shesheve – 3 rruge – me siperfaqe 12 000 m2, - (220 dite/vit)
- heqje e mbetjeve solide nga pikat e grumb. dhe ambjente publike-3.5 ton/dite - (104 dite/vit)
- ndarje ne burim e mbeturinave dhe sistemim i tyre ne vend depozitim–0.6t/dite 104 dite /vit

PREVENTIV

Viti 2019 – shtese e volumeve te mesiperme

Per sherbimin e pastrimit, grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane per bashkine Kucove (shtese njesia Perondi).

Fondi Limit Vjetor i parashikuar:

- 4 119 966 leke (pa tvsh)

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmi mi/nj esi	Dite pune/vit	Vlera
1.	Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	7 200		312	
2.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	ton cope	4,2 45		156	
3.	Larja e konteniereve metalike	“	45		12	
4.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	25 000		220	
5.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	104		104	
6.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”	“	104		104	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

-Viti 2019 – shtese:

- rruge qe fshihen me fshese dore – 4 rruge – me sipërfaqe 7 200 m²- (312 dite pune/vit)
- grumbullim + transportim i mbeturinave urbane – 4,2 ton/dite – 45 kont/dite - (156 dite/vit)
- larje e konteniereve metalike – 1 larje/kontenier/muaj (45 kont/dite.) – ose 12 dite/vit
- lagije e rrugeve e shesheve – 9 rruge – me sipërfaqe 25 000 m², - (220 dite/vit)
- heqje e mbetjeve solide nga pikat e grumb. dhe ambjente publike-3.5 ton/dite - (104 dite/vit)
- ndarje ne burim e mbeturinave dhe sistemim i tyre ne vend depozitim–0.8t/dite 104 dite /vit

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi/ njesi	Dite pune/vit	Vlera
1.	Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	161 000		312	
2.	Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve	“	32 000		52	
3.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	ton	19,7		312	
		cope	253			
4.	Larja e konteniereve metalike	“	60		48	
5.	Sherbimi i pastrimit ne EC-te publike te qytetit	“	4		312	
6.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	73 000		220	
7.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	312		312	
8.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”	“	312/120		216	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

Kontrata per edukimin dhe fushata sensibilizimi per qytetaret per edukimin ambiental – vlera e parashikuar per këto kontrata me nje kohëzgjatje mesatare 33 muaj secila nuk do te jete me e madhe se 20% e vlerës se kontratave per te gjitha njesite vendore (per gjithë kohëzgjatjen e tyre). Parashikohet prodhimi i 2 spoteve 31-50 sek, cdo vit, per transmetim ne 5 TV 2 kombetare, 1 publike e 2 lokale. Frekuenca e transmetimit 1 jave per secilin TV. Frekuenca, fasha orare, e te dhëna te tjera do te jene te vlerësueshme me pike. Mungesa e ofertës se spoteve apo vendosja e te dhënave (teknike dhe ekonomike) te paqena, eshte kusht per skualifikim.

III.3.5. Referuar informacioni të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se në trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ndër të tjera autoriteti kontraktor ka argumentuar se *“Perzgjedhja e marrëveshjes kuader eshte tager i AK dhe jo i OE. OE nuk legjitimohet te ankimoje ne lidhje me perzgjedhjen e procedurave te prokurimit dhe perzgjedhjen e instrumentave prokuruese nga ana e AK. Ato jane nje e drejte e AK dhe perzgjedhja nga ana e AK nuk eshte parashikuar ne LPP si mundesi per ankimim. Ne cdo rast ne lidhje me ligjshmerine e perzgjedhjes, ky mbetet tager i organeve audituese ne shqyrtimet ex post, me efekte rekomanduese (ne cdo rast).”* Në lidhje me këtë çështje, Komisioni i Prokurimit Publik thekson se vendimmarrja e autoritetit kontraktor mbi përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit, aplikimin të marrëveshjes kuadër si edhe hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, fondit limit etj, por pa u kufizuar në këto, është një *“vendim”* në kuptim të nenit 63 pika 1.1. të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* ndaj sa më sipër ankimuesi gëzon legjitimitimin *“locus standi”* të vërë në lëvizje organin shqyrtues administrativ, *quasi gjyqësor* për shqyrtimin e themelit të pretendimeve të këtij të fundit. Në, rastin konkret, në lidhje me përzgjedhjen e marrëveshjes kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për një interpretim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues si edhe parashtrimeve të dërguara në informacionin e administruar pranë KPP-së nga ana e autortietit kontraktor, gjykon t’i referohet metodave të interpretimit ligjor, atij gjuhësor, sistematik dhe teleologjik (*greqishtja e vjetër: telos d.m.th fund/qëllim/objektiv dhe logos d.m.th shkencë/studim*). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përdorimi i marrëveshjes kuadër mes një ose disa operatorëve ekonomikë, nga ana e autoriteteve kontraktore duhet të përmbushë disa parakushte *sine qua non* për aplikimin e kësaj të fundit. Përmbushja e kushteve për aplikimin e marrëveshjes kuadër është esenciale për vetë qëllimet e ligjit të prokurimit publik, një ndër të cilat është edhe nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë. Për këtë qëllim, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm ku në nenin 35/1 pika 7 dhe 8 të *lex specialis*, ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar ka parashikuar *inter allia* se *“Autoritetet kontraktore nuk mund t’i keqpërdorin marrëveshjet kuadër për të penguar, kufizuar apo çrregulluar konkurrencën. 8. Në çdo rast, marrëveshja kuadër zbatohet sipas përcaktimeve të parashikuara në rregullat e prokurimit publik”* Përsa kohë që ligji në fuqi, parashikon se zbatimi i marrëveshjes kuadër do të kryhet sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik, në cilësinë e një dispozite referuese në

aktin nënligjor në fuqi, atëherë i drejtohem i rregullimit të posaçëm të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në nenin 43 të të cilit parashikohet se *“Ndryshimi ndërmjet një marrëveshjeje kuadër dhe kontratave të tjera që lidhen sipas procedurave të prokurimit të parashikuara në LPP është se sasia ose kushte të tjera të mallrave/shërbimeve/punëve, që do të prokurohen, nuk është e përcaktuar në një marrëveshje kuadër. Për këtë arsye, këto lloj marrëveshjesh mund të përdoren kur autoritetet kontraktore e dinë me siguri objektin që do të prokurojnë, por nuk dinë sasinë ose kushte të tjera që do të prokurojnë. Autoritetet kontraktore mund të blejnë vetëm për të plotësuar nevojat e tyre dhe jo për nevoja të autoriteteve kontraktore që nuk janë pjesë në marrëveshjen kuadër.”* Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit njëherazi sasinë e plota të shërbimit të kërkuar duke analizuar në mënyrë analitike për secilin zë të llojit të shërbimit dhe duke dhënë sqarime të plota mbi volumin e shërbimeve të kërkuara për secilin rrugë, shesh, lagje referuar zërave konkretë të shërbimit të kërkuar. Sa më sipër arsyetuar edhe në paragrafin III.3.4 të arsyetimit të këtij vendim, nga ana e autoritetit kontraktor janë parashikuar sasinë për kryerjen e shërbimit të kërkuar duke mos përmbushur një nga dy parakushtet e qëllimit të aplikimit të marrëveshjes kuadër. Akoma më tej, autoriteti kontraktor ka parashikuar edhe rritjen e mundshme vjetore vit pas viti sipas zërave dhe volumeve specifik të shërbimit Gjithashtu, në lidhje me kushtet e tjera të shërbimit, sërish, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor janë parashikuar të dhëna të sakta në lidhje me kushtet e shërbimit. Sa më sipër, KPP gjykon se në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk ndodhet para kushteve të aplikimit të marrëveshjes kuadër duke mos përmbushur asnjë prej dy kushteve (rasteve, të cilat janë mirë përcaktuara në rregullat e prokurimit publik) dhe si e tillë pretendimi i palës ankimuese qëndron.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me përlllogaritjen e fodnit limit me argumentin se *“Fondi limit i përcaktuar nga ana juaj në masën 199,500,000 lekë pa TVSH për katër vitet e kontratës që kërkon të prokurimi dhe që për një vit është 49,875,000 lekë pa TVSH nuk përkon me Vendimin e Këshillit të Bashkisë Kuçovë me nr.82 datë 30.12.2016 “Për Buxhetin e vitti 2017” i cili ka miratuar një fond me 32,009,320 leke me TVSH ose 26,674,435 pa TVSH për shërbimin e pastrimit për vitin 2017. Ku jeni bazuar që keni përcaktuar vlerën vjetore dhe për katër vitet që do të prokuroni e cila është 50 % më e madhe se parashikimi i buxhetit vjetor? Gjatë vitti 2017 në Këshillim Bashkiak të Kuçovës nuk është diskutuar dhe nuk ka patur asnjë miratim për shtesë fondi për shërbimin e pastrimit. Ku e gjeni kurajon dhe mbështetjen për të shkelur ligjin nr.139/2015 “Për qeverisjen vendore” i cili në nenin 40 shprehe se ‘Kryetari i Bashkisë ose personat e autorizuar prej nuk lejohet të kryejnë shpenzime përtej shumës maksimale të shpenzimeve të përcaktuara në zërin përkatës*

në buxhetin vjetor. Nuk lejohen shpenzime të fondeve nesë nuk ka fonde të mjaftueshme në gjendje në bashki për të mbështetur shpenzime të tilla. Në DST e përkatësisht në Specivikimet Teknike e Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit keni paraqitur një studim të plotë e të drejtuar dhe me analiza kostojë për pastrimin, mbledhjen e integruar të mbeturinave në Bashkinë Kuçovë për vitin 2018 si dhe shtesat për njësitë administrative për vitet në vazhdim, të realizuara nga Bashkia dhe me mbështetjen e ndihmën e USAID dhe shoqatës Lëviz Albania e financuar nga qeveria Zviceriane. Për këtë studim u aktivizuan grupe pune, qytetarë dhe veprimtarë si dhe disa nga OJQ në Bashkinë e Kuçovës të cilën monitoruan shërbimin e pastrimit në terren në gjithë territorin e Bashkisë si dhe u zhvilluan shumë takime e dëgjesa publike. Në konkluzionet përfundimtare të këtij aktiviteti gjithëpërfshirës ju e keni quajtur atë një arritje dhe tregues konkret për objektivat e Bashkisë për vitin 2018 e në vazhdim për pastrimin dhe mbledhjen e mbeturinave. Bazuar në këto sa më sipër edhe vlerën në lekë për shërbimin të përcaktuar nga studimi e keni konsideruar reale dhe të saktë si dhe keni përemtuar se do të bëni realitet në buxhetin e vitit 2018 për procedurën e re të tenderimit të shërbimit të pastrimit. Pra bazuar në ato që paraqitni ju, shuma e përcaktuar nga studimi nuk shkon më tepër se gjysma e fondit limit prej 199,500,000 lekë që ju doni të prokuroni. Si është përlogaritur dhe ku bazohet shuma prej 199,500,000 lekë që ju doni të prokuroni?”

III.4.1. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se në informacionin e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, është administruar njëherazi edhe akti nr.2564 prot datë 01.08.2017 i autoritetit kontraktor Bashkia Kuçovë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit-Tiranë, në të cilën është parashtruar edhe fakti se nga ana e Degës së Thesarit Kuçovë, Urdhëri i Prokurimit nuk është konfirmuar për shkak të pa mjaftueshmërisë në fonde në vlerën prej 100,357,437 lekë. Në lidhje me këtë çështje, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autortieti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, referuar informacionit të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk ka sqaruar me dokumentacion justifikues se në momentin e shqyrtimit administrativ të kësaj ankese ka patur një vendimarrje të ndryshme nga ajo e deklaruar në aktin e mësipërm nr.2564 protkollit datë 01.08.2017 nga Dega e Thesarit Kuçovë si apo Ministria e Financave. KPP gjykon se pamjaftueshmëria e mbulimit me fonde publike çënon në thelb zbatimin e kontratës publike. Në nenin 76 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, parashikohet se “Autoriteti kontraktor, për fondet buxhetore, prokuron kontratat për një periudhë deri në mbylljen e vitit buxhetor, përveç rasteve kur lidhen kontrata shtesë, në përputhje me shkronjën “b”, të pikave 3 e 5, të nenit 33 të LPP. 6 Në çdo rast, financimi i kontratave të prokurimit bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.” Gjithashtu, kjo bie në kundërshtim edhe me parashikimet e Udhëzimit nr.2, datë 6.2.2012 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi ndryshimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik/financiar me argumentin se *“Të gjitha kërkesat e mësipërme kanë dalë jashtë kornizave të kërkesave ligjore të nenit 26 VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike autoriteti kontraktor kërkon a) kopje të certifikuar të një ose më shumë bilanceve të paraqitura në autoritetet përkatëse dhe/ose kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Nga sa shohim më sipër ky është një kriter tepër diskriminues dhe i vendosur posaçërisht për të na përjashtuar ne si subjekt pasi në 2 vjetët e fundit kemi punuar me Overdraft nga Banka vetëm sepse ju si AK nuk na keni likuaduar në kohë për punën e kryer. Keni qenë ju si AK që na keni çuar drejt kësaj metode financimi me paaftësinë tuaj paguese për punën e kryer në dy vitet e fundit. Për të mos lënë shërbimin pa kryer ne si OE kemi qenë të detyruar të punojmë me kredi dhe Overdraft nga banka.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se *“*

Subjekti duhet të paraqesë minimalisht një bilanc të vitit të fundit fiskal, i cili duhet të jetë pozitiv. Bilanci/et duhet të jenë të audituara dhe dorezuara në organet kompetente tatimore. Ato duhet të jenë të plota dhe të përmbajnë çdo pasqyre financiare, raport, në përputhje me standartet kombëtare e nderkombëtare të kontabilitetit si dhe udhëzimet e MF. Mosparaqitja e të dhenave të kërkuara sipas këtij paragrafi është kusht për skualifikim. OE duhet të demonstrojë se raporti i debitit është me i lartë se 35% (Raporti = Debiti Total/ Asetet Total).

- 1. Keto kërkesa bazuar në standartet nderkombëtare të kontabilitetit janë paralajmërime për tregues në rnie apo negative dhe nuk ofrojnë garanci për kryerjen e shërbimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi, për detyrimet kontraktuale, për detyrimet tatimore, sigurimet shëndetësore, doganore, financiare, bankare etj.*
- 2. Këto të dhëna do të konsiderohen me indeks negative nga pasqyrat financiare, dhe rrjedhimisht do të skualifikohen:*
 - 2.1 OE paraqet raport të leshuar nga bankat në lidhje me plotesimin e sukseshëm të detyrimeve që ka për zbatimin e kredive të marra.*
 - 2.2 Rritja e stokut dhe dalja e ngadalte e tij do të konsiderohen si tregues negativë.*
 - 2.3 Overdraft në rritje me xhiro vjetore statike/ të pandryshuar në rritje.*

2.4 Përvec bilanceve, OE duhet të paraqese edhe një deklaram të audituesit në lidhje me keto zera të kërkuar nga AK.

III.5.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “c” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilanci, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;”

III.5.3. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 4 gërma “a” dhe “b” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se:

“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon:

a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse; dhe/ose

b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore, ku në asnjë rast, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet; dhe/ose”

III.5.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.5.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon

të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion *me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet* në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.5.6. Në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP vlerëson të sqarojë se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, synimi bazë i autoritetit kontraktor me anë të dokumentacionit të kërkuar është vërtetimi se operatorët ekonomikë pjesëmarrës përmbushin kapacitetin ekonomik dhe financiar në kuptim të nenit 46 pika 1 gërma “c” të *lex specialis*. Referuar dispozitës së sipërcituar, qëllimi i kërimit të dokumentacionit në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar lidhet *stricto sensu* me qëllimin e vërtetimit se operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën. Referuar natyrës së procedurës së prokurimit objekt ankimi, vëllimit të kontratës, mënyrës së financimit të kontratës si edhe mekanizmave të tjerë me anë të të cilave autoriteti kontraktor siguron plotësimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar, kërkitimi i mësipërm që në bilancet e shoqërive pjesëmarrëse të paraqiten detyrimisht të dhënat e sipërcituara është një kërkesë e cila tejkalon synimin e autoritetit kontraktor si edhe njëherazi nuk është në përputhje me natyrën dhe volumin e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se në kërkimin e mësipërm autoriteti kontraktor duhet të kufizohet vetëm në kërkimin e dorëzimit të pasqyrave financiare të hartuara dhe të konfirmuara në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.6. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi ndryshimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik/financiar me argumentin se *“Keni kërkuar që OE te paraqese police sigurimi per pergjegjesine profesionale gjate aktivitetet tregtar per mbulimin e demeve qe mund tju shkaktohen ndaj te treteve. Kjo police duhet te jete e leshuar perpara njoftimit te procedures se prokurimit, nga nje institucion financiar, dhe duhet te mbuloje gjendjen e kapitalit te bilancit me te fundit te shoqerise ose vleren ekuivalente te demeve ne cdo rast jo me te vogel se 50,000 Euro. Vlefshmeria e policës duhet te jete minimalisht 1 vjecare, e nevojshme per te mbuluar detyrimet kontraktore dhe duhet te jete e pakufizuar numrin e demeve. Ne rast se polica eshte leshuar pas njoftimit te kontrates ajo duhet te kete vlefshmeri minimalisht 16 mujore. E pa kuptueshme kjo kërkesë si për afatin para apo mbas njoftimit të procedurës, por mbi të gjitha në kontratat që ne si OE kemi patur me Bashkinë Kuçovë që nga viti 1995 e në vazhdim për vetë llojin e shërbimit, sigurimin shëndetësor dhe të jetës nga aksidentet kemi patur për punonjësit e kompanisë edhe siguracionet e mjeteve të transportit. Kërkojmë që ky kriter të hiqet si i panevojshëm.”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

OE te paraqese police sigurimi per pergjegjesine profesionale gjate aktivitetet tregtar per mbulimin e demeve qe mund tju shkaktohen ndaj te treteve. Kjo police duhet te jete e leshuar perpara njoftimit te procedures se prokurimit, nga nje institucion financiar, dhe duhet te mbuloje gjendjen e kapitalit te bilancit me te fundit te shoqerise ose vleren ekuivalente te demeve ne cdo rast jo me te vogel se 50,000 Euro. Vlefshmeria e policës duhet te jete minimalisht 1 vjecare, e nevojshme per te mbuluar detyrimet kontraktore dhe duhet te jete e pakufizuar numrin e demeve. Ne rast se polica eshte leshuar pas njoftimit te kontrates ajo duhet te kete vlefshmeri minimalisht 16 mujore.

III.6.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

III.6.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.6.4. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.6.5. Në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP vlerëson të sqarojë se referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, synimi bazë i autoritetit kontraktor me anë të dokumentacionit të kërkuar është garancia që subjekti ekonomik disponon *police sigurimi per pergjegjesine profesionale* për dëmet që mund ti shkaktohen palëve të treta gjatë zbatimit të kontratës. Në lidhje me këtë çështje, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për autoritetin kontraktor plotëimi i kushtit të mësipërm është i nevojshëm *ex post* pas lidhjes së kontratës, pasi vërtetimi se subjekti disponon garanci profesionale ndaja palëve të treta në një vlerë jo më të vogël se *50,000 Euro* , për sa kohë që në momentin e dorëzimit të ofertave dhe para lidhjes së kontratës autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ofertues nuk shfaqen në cilësinë e palës, nuk ndikon drejtpërdrejtë ose në mënyrë të tërthortë për autoritetin kontraktor. KPP vlerëson se rrisqet profesionale (gabimeve të mundshme profesionale gjatë zbatimit të kontratës) të cilat mund të bëjnë përgjegjës ligjërisht ndaj palëve të trera operatorin ekonomik të shpallur fitues si dhe njëherazi mund të ndikojnë në zbatimin e kontratës , shfaqen vetëm pas lidhjes së kontratës dhe ndaj, kriteri i mësipërm në cilësinë e një kriteri kualifikues nuk është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës si edhe momentin procedural të kërimit të tij.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.7. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi ndryshimin e kritereve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik/financiar me argumentin se *“Në DST pika 5 e Kapacitetit Teknik thuhet se : Operatori ekonomik duhet te paraqese nje akt marreveshje me nje landfill, largesia e te cilit nuk duhet te jete me e madhe se 55-km nga territori i Bashkise Kucove. Ju si AK në specifikimet teknike e keni përcaktuar saktë vendin e hedhjes së mbeturinave “Ferma Partizani” me të cilat është bërë dhe llogaritja e largësisë dhe kostoja e transportit si dhe harxhimi i karburantit. Atëherë përse duhet kjo marrëveshje. Kërkojmë që të hiqet ky kriter i pa nevojshëm dhe diskriminues”* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

Operatoret ekonomike ofertues qe kane patur marrdhenie kontraktuale te meparshme me ish njesite vendore qe perbejne Bashkine Kucove dhe te cilet kane rezultuar me mospermbushje te suksesshme te objektit dhe detyrimeve perkatese te kontrates , do te skualifikohen.

III.7.2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në shtojcën 11 *“Shërbimi dhe grafiku i ekzekutimit”* në mënyrë të përsëritur ka parashikuar se vendi i grumbullimit të mbetjeve do të jetë *“Ferma Partizani”*, fakt i cili është shprehur në disa drejtime. Konkretisht në seksionin *III. Grumbullimi e transportimi i mbeturinave urbane me konteniere e mjet teknologjik deri ne*

vend depozitimin e mbeturinave. autoriteti kontraktor ka parashikuar se analiza e kostos dhe përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit është hartuar duke marrë në konsideratë se vendi i depozitimit të mbetjeve do të jetë “Femra Partizani”, ku ndër të tjera është shprehur se “Duke patur parasysh te dhenat e mesiperme ne do te llogaritim edhe sasine e karburantit qe duhet per te tre mjetet teknologjike, te cilat do te perdoren nga firma private e sherbimit te pastrimit cdo dite per grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave te ngurta urbane nga njesite Kucove dhe Lumas.Per te nxjerre sasine e karburantit do te marrim ne konsiderate qe kostoja e plote perbehet nga kostoja e grumbullimit te mbeturinave dhe kostoja e transportit te tyre deri ne vend depozitimin e tyre ne Fermen Partizani, per te tre mjetet teknologjike. “ “Pra sasia e karburantit qe duhet per grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave urbane nga pikat e grumbullimit deri ne vend depozitimin e tyre ne Fermen Partizani eshte 21 902 litra gjate gjithë vitit. Kjo e dhene do te na sherbeje per te llogaritur koston e ketij zeri ne analizen e plote te koston se sherbimit te grumbullimit dhe transportimit te mbeturinave urbane .” Gjithashtu në analizën e kostos nr.3 është parashikuar se “Grumbullimi e transportimi i mbeturinave urbane,nga pikat e grumbullimit ne gjithë territorin e bashkise, me konteniere metalike dhe mjet teknologjik deri te vend depozitimi i mbeturinave ne fermen “Partizani” Gjithashtu, në seksionin 7 është parashikuar se “VII. Heqja e mbetjeve solide nga pikat e grumbullimit dhe ambjentet e tjera publike ne te gjithë qytetin, me skuadren e pastrimit.

Gjate veprimtarise se tyre te perditshme familjet, bizneset dhe institucionet prodhojne mbeturina urbane, te cilat grumbullohen e transportohen nga firma sipermarrese e pastrimit deri ne vend depozitimin e tyre ne Fermen Partizani. Por krahas mbeturinave urbane familjet nxjerrin edhe mbetje solide (dhera, materiale inerte, ndertimore etj.) te cilat i hedhin ne pikat e grumbullimit ose ambjente te tjera publike.Bashkia Kucove ka marre masa te rrepta per te parandaluar kete fenomen dhe ia ka bere te qarte qytetareve se mbetjet solide duhet te mos i hedhin te pikat e grumbullimit te mbeturinave urbane dhe t'i largojne me shpenzimet e tyre, per ne vend depozitimin e tyre te gropat e bitumit te ish UPN. Ka shume raste qe qytetare te papergjegjshem i hedhin mbetjet solide prane pikave te grumbullimit , fshehurazi e sidomos naten.Kur i gjejme autoret policia bashkiake i detyron t'i largojne vete qytetaret, bile edhe duke i gjobitur.Por ne shume raste ne nuk i gjejme dot fajtoret dhe detyrohemi t'i largojme me automjetet e firmes sipermarrese, duke futur ne analizat e koston edhe kete sherbim”. Në seksionin 8 është parashikuar se “ VIII. Ndarja e mbeturinave sipas perberjes mercologjike, ne dy rryma kryesore me qellim riperdorimin dhe riciklimin e mbeturinave urbane. Sistemimi i mbeturinave urbane ne vend depozitimin e tyre ne fermen “Partizani”, rreth 4 km nga qyteti Kucove” “Vend depozitimi i mbeturinave urbane ne fermen “Partizani”, rreth 4 km larg nga qyteti i Kucoves”

III.7.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “ b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.7.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin në rast se kriteri i mësipërm është në proporcion *me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet* në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.7.6. Në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP vlerëson të sqarojë se referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit, synimi bazë i autoritetit kontraktor me anë të dokumentacionit të kërkuar është garancia se operatori ekonomik i shpallur fitues do të kryejë shërbimin duke depozituar në vendin e parashikuar të grumbullimit të mbetjeve, mbetjet urbane. Në lidhje me këtë çështje, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi se vendi i parashikuar është “*Ferma Partizani*” duke pasqyruar edhe distancën e vend grumbullimit të mbetjeve nga qyteti, si edhe duke parashikuar edhe proceset e punës të cilat do të kryhen në këtë vend grumbullim. Gjithashtu, KPP konstaton se në analizën e kostos së hartuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe publikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, përllogaritja e fondit limit është kryer duke marrë në konsideratë edhe vend grumbullimin e mbetjeve të parashikaura, si bazë e përllogaritjes së distancës që duhet të kryejnë mjetet, orët e punës si edhe sasinë e parashikuar të karburantit të nevojshëm. Sa më sipër, KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka mirëpërcaktuar vendin e grumbullimit të mbetjeve dhe nuk ka lënë në vlerësimin e operatorëve ekonomikë të përzgjedhin një vend të ndryshëm për të cilin, këto të

fundit duhet të dëshmonin se disponojnë kontratë/marrëveshje partneriteti. Sa më sipër, analizuar, në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, KPP gjykon se kërkesa e mësipërm nuk është proporcione me natyrën, volumin e kontratës objekt prokurimi si edhe nuk i shërben synimit të autoritetit kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

III.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimese mbi ndryshimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik/financiar me argumentin se “Në DST pika 5 e Kapacitetit Teknik thuhet se : Në kërkesat për mjetet ka një mos rakordim me specifikimet teknike sepse në preventiv ka fshirje me makineri teknologjike dhe në kërkesa nuk kërkohet makinë fshesë, mjetet teknologjike të kërkuara janë më shumë se sa duhet sipas specifikimeve teknike. Kamionat vetëshkarkues kërkohen më shumë se sa duhen referuar specifikimeve teknike. Po kështu, diskriminues është edhe viti i prodhimit të mjeteve të cilat kërkohen të jenë të vitit të prodhimit jo më poshtë se viti 2003” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

1. Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e shërbimit, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

e) Makinerite që duhet të disponojë shoqëria për realizimin e shërbimit, duhet të jenë të vit prodhimit minimalisht të v. 2003, duhet të jenë të plota dhe të pajisura me të gjithë aksesoret e nevojshëm e të mundshëm për të realizuar qëllimin dhe objektin e kontratave:

Makine teknologjike me kapacitet min. 9-10 ton	4 cope
Mjet transporti vetëshkarkues \geq 9-10 tone	4 cope
Autobot uji min. 7t	1 cope

Mjetet duhet të jenë në pronësi dhe të jenë të shënuara në regjistra publikë. OE duhet të paraqesë dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat ,si edhe leja e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë.

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.
- Për mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet afati i kontratës që duhet të përfshijë gjithë periudhën e realizimit të shërbimit, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin

e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit taksat, si edhe lejen e transportit nga komuna apo bashkia për vete ose të tretë.

III.7.2. Në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor krahas dokumentave të tenderit janë publikuar specifikimet teknike si dhe preventivi me zërat e shëbrimit që do të kryhen. Konkretisht, në preventivin e vitit 2017 autoriteti kontraktor ka parashikuar kryerjen e shërbimit si më poshtë vijon:

- **Viti 2017 e ne vijim**

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Çmimi/njesi	Dite pune/vit	Vlera
1.	Fshira me fshese dore e rrugeve dhe shesheve	m ²	161 000		312	
2.	Fshirja me mjet teknologjik e rrugeve e shesheve	“	32 000		52	
3.	Grumbullim e transportim te mbeturinave urbane ne vend depozitim (per kontenier)	ton	19,7		312	
		cope	253			
4.	Larja e konteniereve metalike	“	60		48	
5.	Sherbimi i pastrimit ne EC-te publike te qytetit	“	4		312	
6.	Lagije rruge e sheshe me mjet teknologjik	m ²	73 000		220	
7.	Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit	dite	312		312	
8.	Ndarja e mbeturinave ne burim dhe sistemimi i tyre ne vend depozitim ne Fermen “Partizani”	“	312/120		216	
	Shuma					
	TVSH 20%					
	Shuma totale					

III.7.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se “

Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës

III.7.3. Në nenin 28, pika 5, gërma “ç” të Vendimit nr.914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

cc) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimes, KPP konstaton se ankimesi parashtron kundërshtime si në lidhje me numrin e mjeteve gjithashtu edhe në lidhje me vitin e prodhimit të tyre. Në lidhje me kërkimin e parë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, volumit të saj, si edhe specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në të cilën, për vitin 2017 është parashikuar mbledhja dhe grumbullimi i mbetjeve urbane në sasinë në total 19.7 ton në ditë, e cila shfaqet si në preventivin e shërbimit gjithashtu edhe në specifikimet teknik ku autoriteti kontraktor shprehet se “Pra, per qytetin Kucove dhe njesine administrative Lumas sasia e mbeturinave qe gjenerohen cdo dite ne total eshte 19.7 ton” Referuar specifikimeve të mjeteve, autoriteti kontraktor ka parashikuar disponueshmërinë e 4 mjeteve teknologjike me kapacitet mbajtës minimal 9-10 ton (pra në total 36-40 ton) dhe 4 mjeteve vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës më e madhe ose e barabartë me 9-10 ton pra (36-40 ton) në total mjete me kapacitet mbajtës rreth 80 ton. Gjithashtu, për vitet në vijim, autoriteti kontraktor ka parashikuar zgjerimin e volumit ditor të shërbimit. Sa më sipër, KPP gjykon se kërkimi i autoritetit kontraktor në lidhje me mjetet e sipërcituar, parë kjo në raport me

volumin ditor të grumbullimit të mbetjeve, grafikun e shërbimit, numrit total të kontenierëve, nuk është në proporcion me volumin dhe natyrën e kontratës dhe sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të parashikojë në kërkesat për kualifikim, kapaciteti teknik mjete dhe paisje në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës. Në lidhje më kërkimin e autoritetit kontraktor mbi vitin e prodhimit të mjeteve, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, i shërben njëherazi jo vetëm proceseve të punës së parashikuar por njëkohësisht edhe ndikimit të tyre në mjedis.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese pjesërisht qëndron

III.8. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi ndryshimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, me argumentin se *“Lidhur me edukimin publik ju keni kërkuar “Kontrata per edukimin dhe fushata sensibilizimi per qytetaret per edukimin ambiental – vlera e parashikuar per këto kontrata me nje kohëzgjatje mesatare 33 muaj secila nuk do te jete me e madhe se 20% e vlerës se kontratave per te gjitha njesite vendore (per gjithë kohëzgjatjen e tyre). Parashikohet prodhimi i 2 spoteve 31-50 sek, cdo vit, per transmetim ne 5 TV 2 kombetare, 1 publike e 2 lokale. Frekuenca e transmetimit 1 jave per secilin TV. Frekuenca, fasha orare, e te dhëna te tjera do te jene te vlerësueshme me pike. Mungesa e ofertës se spoteve apo vendosja e te dhënave (teknike dhe ekonomike) te paqena, eshte kusht per skualifikim.” Një kriter i cili është shumë evaziv dhe zë një vlerë tepër të konsiderueshme të shumës së kontratës. I pa përcaktuar në zërat e preventivit ku i është lënë një hapësirë në të cilën mund të abuzohet lehtësisht. Ky kriter nuk është vendosur në kriteret e veçanta të kualifikimit, por i feshur posaçërisht nëpër DST pikërisht për të ngatërruar operatorët operatorët ekonomikë në kundërshtim me LPP dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 ku thuhet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontrktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.8.1. Në shtojcën 9 *“Specifikime teknike”* të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se “

Kontrata per edukimin dhe fushata sensibilizimi per qytetaret per edukimin ambiental – vlera e parashikuar per këto kontrata me nje kohëzgjatje mesatare 33 muaj secila nuk do te jete me e madhe se 20% e vlerës se kontratave per te gjitha njesite vendore (per gjithë kohëzgjatjen e tyre). Parashikohet prodhimi i 2 spoteve 31-50 sek, cdo vit, per transmetim ne 5 TV 2 kombetare, 1 publike e 2 lokale. Frekuenca e transmetimit 1 jave per secilin TV. Frekuenca, fasha orare, e te dhëna te tjera do te jene te vlerësueshme me pike.

Mungesa e ofertës së spoteve apo vendosja e të dhënave (teknike dhe ekonomike) të paqena, është kusht për skualifikim.

III.8.2. Në nenin 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se : “ *Njësia e prokurimit është përgjegjëse për:*

- *sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrit të parashikimit dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit publik;*
- *përzgjedhjen e llojit të procedurës së prokurimit (dhe justifikimin kur është rasti);*
- *përlllogaritjen e fondit limit, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- *hartimin e urdhrat të prokurimit;*
- *përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme;*
- *hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore;*
- *administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit, duke përfshirë edhe procesverbalet e mbledhjeve, kur është rasti;*
- *llogaritjen e çmimeve të shitjes së dokumenteve të tenderit që u jepen operatorëve ekonomikë me kërkesë të tyre, kur është rasti.”*

III.8.3. Në lidhje me kërkimin e mësipërm të autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar preventivave të shërbimit të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, nuk është parashikuar në mënyrë të qartë dhe eksplicite zëri në lidhje me edukimin ambiental dhe fushatat sensibilizuese. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, njësia e prokurimit duhet të hartojë dokumentet e procedurës në përputhje me parashikimet e nenit 57 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar duke parashikuar në mënyrë të qartë preventivin e shërbimeve, natyrën e shërbimeve të parashikuar, sasinë e tyre, kohëzgjatjen e ofrimit të shërbimit (spoteve, fushatës sensibilizuese) në mënyrë të tillë që edhe operatorët ekonomikë pjesëmarrës të mos shfaqin paqartësi në momentin e hartimit të ofertës ekonomike drejtuar autoritetit kontraktor. Gjithashtu, KPP gjykon se edhe në përlllogaritjen e fondit limit, autoriteti kontraktor, krahas shërbimeve të tjera duhet të përlllogarisë edhe mbi këtë shërbim të kërkuar në drejtim të zhvillimit të fushatave sensibilizuese me synim edukimin mjedisor.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.

III.9. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues mbi ndryshimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, me argumentin se “Përsa i përket kriterit të vlerësimit të ofertës si Oferta Ekonomikisht më e favorshme theksojmë se duhet hequri si kriter vlerësimi sepse vetë

kriteret që ju keni vendosur janë kualifikuese dhe jo opsionale. Edhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 shprehet se “ Për punët mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët. Prandaj kërkohet që edhe ky kriter vlerësimi i ofertës të ndryshohet.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në seksionin 4.2. të “Formularit të Njoftimit të Kontratës” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi autoriteti kontraktor ka parashikuar se “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) çmimi më i ulët

Ose

B) oferta ekonomike më e favorshme X

lidhur me rëndësinë: Çmimi 65 pikë


Teknike etj. 35 pikë

III.9.2. Në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi, në lidhje me vlerësimin e ofertës ekonomike më të favorshme dhe metodës së kryerjes së vlerësimit autoriteti kontraktor ka parashikuar se “

Kriteret e vlerësimit:

Cilesia: 35 pike te ndara si me poshte (Faktori i peshuar ne peshe e pikeve):		Kosto: 65 pike te ndara si me poshte (faktori i peshuar ne peshe e pikeve):	
Metoda e propozuar e pastrimit dhe plani i investimit	[0-45%]	Cmimi i kontrates	[0-80%]
Plan Investimi/ Kosto e jetes se investimit, kosto qe lidhet me blerjen, kosto e perdorimit/ konsumit dhe burimeve te tjera / kosto e mirembajtjes dhe pjeseve te kembimit			
50-% të pikëve)			
Përvoja e OE dhe stafit me projekte të			

<p><i>ngjashme lokale dhe rajonale 3%</i></p> <p><i>Përvoja e stafit kyc, certifikimet 3%</i></p> <p><i>Specifikimet e Sistemeve, mjeteve ekzistuese - 20%</i></p> <p><i>Plani i mobilizimit (frekuenca pa kosto shprese) – 10%</i></p> <p><i>Manaxhimi i riskut – 11%</i></p> <p><i>Te tjera 3%</i></p> <p><i>-Pastrimi mekanik i rrugeve me fshese dore dhe mjet teknologjik – shume e rendesishme</i></p> <p><i>-Grumbullimi dhe transportimi i mbeturinave urbane me konteniere e mjet teknologjik -</i></p> <p><i>-larja e konteniereve metalike me mjet teknologjik –</i></p> <p><i>-sherbimi pastrimit ne kater EC publike ne qytet –</i></p> <p><i>-heqja e mbetjeve solide (dhera, materiale inerte etj.) nga pikat e grumbullimit ose hapësira te tjera publike –</i></p> <p><i>-ndarja ne burim dhe sistemimi i mbeturinave urbane ne vend depozitim/ landfill –</i></p> <p><i>(totali 100%)</i></p> <p><i>(vitet e punës do të jenë të peshuara proporcionalisht për cdo pjestar të</i></p>		
--	--	--



<p>stafit).</p> <p>Parametrat teknike do të peshohen me pikë për cdo specifikim të kërkuar në mënyrë proporcionale. Në rast se parametrat janë më të mirë ato do të vlerësohen me më shumë pikë.(elementet e vleresimit do te jene viti i prodhimit, kapaciteti pastrues/ mbajtes)</p>			
<p>Edukimi Publik dhe Ambiental i qytetareve.</p> <p>Metodologjia dhe Projekt ideja (te jete e strukturuar dhe e ndare ne modelet SMART ose SËOT ose BDS) ne varësi te zgjidhjes se propozuar duhet te permbaje edhe regji, montazh 3d, staf ndihmues, banera, postera, pamflete, etj zgjidhja duhet te jete edhe mediatike dhe sensibilizuese ne terren – target grupet – rezultatet e pritshme, etj -30% te pikëve</p> <p>organi i masmedias/medium/ agjencia e specializuar (kombëtar/e dhe vendor/e); - 30% te pikeve</p> <p>Koha e transmetim/ sensibilizim & frekuenca – 30% te pikeve</p>	<p>[0-55%]</p>	<p>Çmimet per edukimin qytetar per njësi. Piket do te shperndahen proporcionalisht per cdo ze shërbimi dhe analizat e tyre.</p>	<p>[0-11%]</p>
		<p>Cmim per njësi i zërave te kërkuara/ kosto direkte e indirekte</p>	<p>9%</p>

	100%		100%
<i>Totali i pikeve ne perqindje eshte</i>		<i>Totali i pikeve ne perqindje eshte</i>	
<p><i>OE duhet te arrije minimalisht 50% te pikeve per tu konsideruar teknikisht i pershtatshem.</i></p> <p><i>Fillimisht do te mblidhen nenkriteret ne perqindje pervec nenkriterit afati i perfundimit te punimeve i cili shtohet ne fund. Proporcionalisht me perqindjen e pikeve do te behet zbritja e maksimumit te pikeve qe jepen.</i></p>		<p><i>Me pas OE do te vleresohet me konvertimin e peshes me pike si vijon: $100\% / 60 = 65$ pike. Oferta qe merr me pak se 50% te pikeve do te konsiderohet anomalisht e ulet dhe do i nenshtrohet procesit te shqyrtimit te detajuar administrativ. Nese oferta nuk ploteson kerkesat e AK dhe legjislacionit ne fuqi, do te konsiderohet e papranueshme, e papershtashme. Vlera me e ulet e kriterit qe vleresohet (p.sh 5000) x 65 pike (piket maksimale qe jepen kriterit) / treguesin e ofertes qe vleresohet (6000) = 50 pike</i></p>	
<i>Vleresimi perfundimtar A (40) + B (60) = 100 pike</i>			

Per kriteret teknike do te aplikohet kjo metodologji:

Per karakteristikat teknike ne form cilesie vleresimi do te behet proporcionalisht me piket e alokuara per ate nenkriter (nenkriteri konsiderohet se pesha e tij eshte 100%) sipas percaktimeve te DST me sipër ($Pk1 = Vmink1 \times Pmax1 / Ok1$), ne rastet kur vlera me e larte eshte me cilesore se vlera e ulet, vleresimi do te behet bazuar ne parimin e proporcionalitetit sipas kesaj formule formula do te behetndryshon vendndodhjen e kriterit me te ulet me kriterin me te larte $Pk1 = Ok1 \times Pmax1 / VmaxK1$

Per karakteristikat teknike ku kerkohet zgjidhja apo ofrimi i nje sherbimi te pershtjelluar, metodologjia do te jete si me poshte, per cdo kriter, nenkriter ne raport me piket e alokuara:

(i)

Piket	Kriteri per vleresimin e pikeve
0	<i>Nuk arrin te plotesoje standartet e kerkuara ose nuk ofron asnje propozim</i>

10%	<i>Propozimi dukshem nuk ploteson standartet e kerkuara, permban mungesa/ probleme dhe / ose eshte jo e perpuethshme/ inkonsistente me propozime te tjera.</i>
25%	<i>Propozimi eshte i shkurter dhe nuk arrin standartet e kerkuara ne nje numer te identifikuar aspektesh teknike te rendesishme dhe risku kalon tek AK per shkak te mosqartesis se tyre ose kopjon te dhënat e AK pa asnjë trajtim te mëtejshëm duke i ofruar si te dhënat e veta</i>
50-55%	<i>Propozimi ploteson standartet teknike te kerkuara ne pjesen me te madhe te materialeve, por nuk ka konsistence dhe mungon konsistenca tek te tjerat</i>
80-85%	<i>Propozimi i ploteson standartet e kerkuara ne te gjitha aspektet material</i>
95-100%	<i>Propozimi i ploteson standartet e kerkuara per cdo material (te gjitha aspektet material) dhe ne disa prej tyre apo ne teresiine e tyre tejkalon kerkesat kryesore</i>

OE duhet të paraqesë listën e punonjësve që do të vendosë në dispozicion të AK, një CV të stafit kyç dhe një organigramë të detajuar me detyra, role dhe përgjegjësi. Si dhe projektet e angazhuara nga OE për natyra të ngjashme punimesh.

V.O. Oferta teknike duhet te permbaje shpjegime, te dhëna narrative dhe jo ngarkim dokumentash. Ne rastin e ngarkimit te dokumentave sado domethënëse te jene ato do te marrin 0 pike per secilin ze te kërkuar ne vlerësim. Oferta ekonomike duhet te plotësohet me çmime per njësi dhe ne sasi sipas parashikimeve te DST me kohëzgjatjet e parashikura maksimaliste ne Kalendarin e MK përfshi edhe edukimin. Oferta qe nuk paraqitet sipas kësaj kerkese do te refuzohet per vlerësim te mëtejshëm.

III.9.3. Në nenin 55 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se “

Oferta fituese duhet të jetë:

a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët; ose

b) oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistenca teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese”

III.9.3. Në nenin 31 pika 1 dhe 2 e Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se “

1. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta ose standarde teknike të mirënjohura, kriter vlerësimi do të jetë oferta me çmimin më të ulët.
2. Kriteri i ofertës ekonomike më të favorshme do të përdoret në kontratakomplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderi”

III.9.4. Në rastin konkret, në lidhje me përzgjedhjen si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, kriterin e ofertës ekonomike më të favorshme, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për një interpretim të drejtë të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues si edhe parashtrimeve të dërguara në informacionin e administruar pranë KPP-së nga ana e autoritetit kontraktor, gjykon t’i referohet metodave të interpretimit ligjor, atij gjuhësor, sistematik dhe teleologjik (greqishtja e vjetër: telos d.m.th fund/qëllim/objektiv dhe logos d.m.th shkencë/studim). Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përzgjedhja e ofertës fituese me anë të ofertës ekonomike më të favorshme, nga ana e autoriteteve kontraktore duhet të përmbushë disa parakushte sine qua non për aplikimin e kësaj të fundit. Përmbushja e kushteve është esenciale për vetë qëllimet e ligjit të prokurimit publik, mirëpërdorimin e fondeve publike. Për këtë qëllim, ligjvënësi është treguar i kujdesshëm ku në nenin 55 pika 1 gërma “b” të lex specialis, ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ka parashikuar inter allia se “oferta ekonomike më të favorshme, bazuar në kritere të ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: cilësia, çmimi, cilësitë teknike, karakteristikat estetike, funksionale, mjedisore, kostot e funksionimit, efektshmëria ekonomike, shërbimi pas shitjes dhe asistencë teknike, data dhe periudha e lëvrimit ose periudha e ekzekutimit, me kusht që këto kritere të jenë objektive dhe jodiskriminuese”” Gjithashtu, për rregullimet e mëtejshme të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter për përzgjedhjen e ofertës fituese i referohemi edhe rregullimit të posaçëm të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në nenin 33 pika 2 të të cilit parashikohet se “Kriteri i ofertës ekonomike më të favorshme do të përdoret në kontratakomplekse dhe të një natyre të veçantë që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmbajnë dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin” Në rastin konkret, KPP konstaton se referuar

dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka publikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit njëherazi sasi të e plota të shërbimit të kërkuar duke analizuar në mënyrë analitike për secilin zë të llojit të shërbimit dhe duke dhënë sqarime të plota mbi volumin e shërbimeve të kërkuara për secilin rrugë, shesh, lagje referuar zërave konkretë të shërbimit të kërkuar. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka parashikuar kostot e plota të shërbimit, vitin minimal të mjeteve teknologjike të kërkuara (viti 2003) duke i konsideruar këto të fundit si më miqësore me mjedisin referuar mjeteve të prodhuara para këtij viti si edhe ka parashikuar kosto të plota të shërbimit, specifikime teknike (duke dhënë njëherazi edhe zgjidhjen e metodës së kryerjes së shërbimit, duke përcaktuar sasi të dhe grafikun e shërbimit të kërkuar). Sa më sipër, KPP gjykon se në rastin konkret përzgjedhja e ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese ku çmimi ka peshën e 65 % dhe 35 % i jepet zgjidhjes teknike nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në përzgjedhjen e kriterëve të vlerësimit të ofertave në procedurat e prokurimit publik, autoritetet kontraktor duhet ti qëndrojnë strikt rregullimit ligjor dhe duhet të përzgjedhin atë kriter i cili i përshtatet volumit, natyrës dhe kompleksitetit të procedurës së prokurimit të parashikuar për t'u zhvilluar. Sa më sipër në rastin konkret referuar natyës së procedurës së prokurimit objekt ankimi, llojit të shërbimit të kërkuar objekt i kontratës, nuk përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetin kontraktor shpenzime të tilla, si kostot e shërbimeve pas shitjes, pjesët e këmbimit, zgjidhjet më të favorshme teknike, mbështetjen teknike në të ardhmen apo ato që ndotin më pak mjedisin.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.10. Referuar sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në përfundim të shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, referuar arsyetimit të vendimit, krahas pranimit të modifikimit të disa prej kriterëve të veçanta të kualifikimit, njëherazi është vendosur edhe pranimi i ndryshimit të përzgjedhjes të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese, përzgjedhja e marrëveshjes kuadër si edhe vetë përlllogaritja e fondit limit të procedurës së prokurimit. Në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese.” Sa më sipër arsyetuar, K.P.P. gjykon se, për shkak shkeljeve të konstatuara autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e mësipërme duke modifikuar njëherazi edhe kriteret e veçanta të kualifikimit konstatuar në këtë vendim.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri:

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Higjena” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me objekt “Shërbim I pastrimit, mbledhjen dhe transportimit të mbetjeve urbane në Bashkinë Kuçovë” me nr. Ref 20552-07-13-2017 me fond limit 199,500,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datë 05.08.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kuçovë
2. Të anulojë procedurën e prokurimit dhe me rishpalljen e saj autoriteti kontraktor të hartojë kriteret e veçanta të kualifikimit në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryer
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Higjena” sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1339Protokolli; Datë 28.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha